


**SUPLEMENTI "FUNDJAVA"** ► Faqe 13-17

■ **MONIKA LUBONJA, UDHETIMI PARAJSA TJETËR**

*Preferon largimin nga rutina e përditshme, ja arsyet*

■ **"DJANGO" PREK SUKSESIN, VJEN "TE MJERET"**

*Fundjava me surpriza në kinema dhe teatër*



## Legalizimet

**Listat e reja të banorëve që marrin tapitë në 2013**

► Faqe 19-21


# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi "FUNDJAVA"

VITI III - NR. 18 E premte, 25-01-2013


**Fjalëkryqet e fundit nga**

Kadri Vokopola

► Faqe 23



**FRAZAT THUMBUESE TE DOKLES**

## E shkruar në vitin 2010, pjesa po luhej në Teatrin "Andon Z.Çajupi" në Korçë

# JA DRAMA E NDALUAR

## "Shën Mëria kuçkë", dialogjet që provokuan

Bisedat për Kostandinin, personazhi i Onufrit, përfytyrimi për Shën Mërinë nga murgeshë në mëkatare provokojnë Mitropolinë e Korçës: Është një dramë fyese e provokative ► Faqe 18

**BLOG/ PERIFERI** ► Faqe 6



SHQIPËRIA 1 EURO, TE PA RREGULLA

NGA ALBA MALLTEZI

**INTERVISTA** ► Faqe 4



### Gjinushi: Fitojmë mbi 60 përqind edhe pa LSI

**NE TIRANE** ► Faqe 8

### Sherri, djali i ambasadorit plagos 25-vjeçarin

**"TOP STORY"** ► Faqe 6

### Llalla: 21 janari si tragjedia e 1997 përgjegjësit do dalin para ligjit

**JA FOTO E PARE E LILJANA KONDAKÇI** ► Faqe 12






NË FOTO: (në rreth) Liljana Kondakçi në një nga lokalet e Tiranës pranë Teatrit "Metropol"

## Kondakçi: Unë e dënuar? Me ata që më fyen, do merret Zoti

*Këngëtarja e akuzuar për trafik droge: Më kanë bërë me 5 shtëpi*

**DEBATI PER KOALICIONET**

# Rama takon aleatët, 30 parti do të mblidhen te selia e Gjinushit

Dule: S'dua Idrizin. Reagon kreu i PDIU: Sillet si 'Agimi i Artë'









**TIRANE**

JAKIN MARENA

Kryetari i PS Edi Rama ka mbledhur në selinë e PS partitë aleate, duke startuar në këtë mënyrë fushatën... ► Faqe 2-3

**Koment**



NGA AFRIM KRASNIQI

## Dy zgjidhje për integrimin

Në tetor Bashkimi Evropian apeloi qeverinë dhe opozitën në Shqipëri të gjenin konsensus për ligjet themelore, si dhe të jepnin garanci të plota për seriozitetin e luftës antikorrupsion dhe procesin zgjedhor të qershorit 2013. Tirana politike e refuzoi apelin dhe dy partitë kryesore parlamentare vendosën kushte... ► vijon në faqe 22

**Koment**



NGA GENCI KOJDHELI

## Krimi, ose pasqyra e vërtetë

Para pak ditësh një 21-vjeçar u vra në qytetin e Fierit, dhe sipas policisë shkaku ishte grabitja e një shume prej 60 mijë lekësh që i riu sapo kishte fituar me baste sportive. Po sipas policisë, vrasja me shumë gjasa është kryer nga një shok. Kronikë e zezë, një lajm pak a shumë i zakonshëm për veshët e shqiptarëve... ► vijon në faqe 22

## Topalli e "zgjidh" qesen për deputetët, denoncoi "Shqiptarja.com"

**Administrata e Kuvendit të Shqipërisë, më në fund, ka zhbllokuar pagesën për dietat, tarifat e celularëve dhe karburantin, që u takon me ligj deputetëve për dy muajt e fundit të vitit të kaluar nëntor e dhjetor. Kjo ndodhi pas publikimit në Shqiptarja.com të artikullit me titull "Topalli bllokon paratë, protesta e deputetëve: Duam dietat". Thesari i shtetit ka kryer dje lëvizjet e fondeve: 305.099 lekë kanë kaluar në BKT, 116.725 lekë kanë kaluar në First Investment Bank, 335.504 lekë kanë kaluar në bankën Intesa Sanpaolo, 804.650 lekë në Societe Generale e 829.725 lekë në Raiffeisen. Pagesa më e madhe është bërë nëpërmjet Bankës Credins, ku kanë kaluar nga llogaria e Kuvendit 13.305.223 lekë për dieta, telefona e karburant të deputetëve. Në total, janë 15.7 milionë lekë të reja, ose 112 mijë euro që kanë kaluar në favor të tyre nga buxheti.**




### Organizimi për zgjedhjet, Rama mbledh aleatët. Skemë antivjedhje

# Selia e Gjinushit, zyrë për opozitën e bashkuar

## Marrëveshja mes 30 partive brenda shkurtit. Dhe aleatë të tjerë






**Lajmi**

**Kryetari i PS Edi Rama ka mbledhur në selinë e PS partitë aleate, duke startuar në këtë mënyrë fushatën elektorale. Duke e cilësuar si një fillim të mbarë është folur në parim për bashkëpunimin për ruajtjen e votës por dhe për nënshkrimin e marrëveshjes mes tyre.**

**FRD e AK**

"Mendoj se ka parti politike që s'është e nevojshme që të japin përgjigje tani për koalicionin. Që në momentin e duhur do ta shohin të logjikshme për të vendosur për koalicionin, duke bashkëpnuar nëpermjet integrimit në koalicion, apo nëpërmejt formave të tjera politike", tha Koçi.

TIRANE

JAKIN MARENA

Kreu socialist Rama pas shumë muajsh ka mbledhur dje të gjitha partitë opozitare, me të cilët ka vënë piketat e bashkëpunimit për fushatën e ardhshme elektorale. Organizimi për zgjedhjet e ardhshme ishte në qendër të diskutimit të këtij takim me aleatët, që u zhvillua për rreth 1 orë e 20 minuta në selinë rozë, me pjesëmarrjen e kreut të PSD, Skënder Gjinushi, liderit të PDS, Paskal Milo, kryetarit të PSV91, Petro Koçi, kreut të PLD, Spartak Ngjela dhe të mbi 20 krerërëve të partive të tjera të vogla opozitare. Në takim mungoi kryetari i PBDNJ Vangjel Dule, për të cilin u tha se mungesat që vijnë për arsy teknike s'kanë nevojë për pyetje politike. Mësohet se në takimin me dyer të mbyllura është vendosur fillimisht që te selia e PSD të Gjinushit të jetë zyra e opozitës së bashkuar ku do bëhen të gjitha deklaratat në emër të saj. Një vend të veçantë ka zënë skema për mbrojtjen e votës, ku PS e cila ka dhe komisionerë do të jetë në krye të kesaj skeme për të ruajtur dhe votat e aleatëve. Por dhe për mënyrën e maksimalizimit të votës, dërgimin e çdo votuesi të majtë e opozitar në kuti, komisionerë që të mos shesin votën. Ndërkohë që të gjithë krerët e partive kanë diskutuar nevojën e krijimit të një frymë opozitare për fushatën, se çfarë i bashkon të gjitha bashkë për të kërkuar votën e qytetarëve, ku në qendër të së cilës të jetë kombi, shteti dhe rikthimi i dinjitetit të tij dhe të institucioneve, qytetari dhe nxjerrja e tij nga humnera ku kjo qeveri e ka futur. Pas kërkesës së krerëve aleatë është rënë dakord që në lidhje me marrëveshjen e koalicionit secila parti të dërgojë propozimet, me kërkesat e saja konkrete, objektivat që do kenë në këto zgjedhje dhe do të operohet mbi bazën e detajimit të kontributit në zgjedhjet, që nesë do të marrë dhe vlerësimin në qeverisje, sipas kuotave të përcaktuara për një anëtar kabineti, ose për nivele të tkera të qeverisjes. Marrëveshjet do të jenë bilaterale, të cilat duhet të përundojnë së nënshkruari deri në fund të shkurtit dhe më pas të nënshkruhet marrëveshja kuadër e të gjitha partive të koalicionit, me program e platformë të përbashkët mbi bazën e të cilit do hartohet bashkëqeverisja.

**"Marrëveshje bilaterale që do e bëjë kreu i PS me secilën parti. Është një frymë për fitore nga ky koalicion.**

**PARTI POLITIKE DHE KOALICIONE TË REGJISTRUARA PËR ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE TE DATES 8 MAJ 2011**

**II. ALEANCA PER TE ARDHMEN**

| NR. | përbërë nga partitë e mëposhtme | Iniciale | Kryetari |
|---|---|---|---|
| 1 | Partia Aleanca Arbnore Kombëtare | AAK | Gjet Ndoj |
| 2 | Partia Ardhmëria Shqiptare | PASH | Emin Subashi |
| 3 | Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar | PBPPSH | Selami Jenishehri |
| 4 | Partia Bashkimi Rebublikan Shqiptar | PBR | Zane Llazi |
| 5 | Partia Demokracia Sociale | PDS | Paskal Milo |
| 6 | Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet | PDIP | Halim Seitaj |
| 7 | Partia Demokratike e Bashkimit Mysliman të Shqiperisë | PDBMSH | Sabri Jacaj |
| 8 | Partia e Gjelbër | PGJ | Edlir Petanaj |
| 9 | Partia e Pajtimit Kombëtar | PPK | Spartak Dobi |
| 10 | Partia e Punës e Shqiperisë e Riorganizuar | PPSHR | Marko Dajti |
| 11 | Partia e Unitetit Kombëtar | PUK | Idajet Beqiri |
| 12 | Partia G99 | G99 | Ervin Mete |
| 13 | Partia Ligj dhe Drejtësi | PLiDr | Spartak Ngjela |
| 14 | Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve | PMDE | Ymer Kurti |
| 15 | Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorve të Shqipërisë | PMDPSH | Kadri Isufaj |
| 16 | Partia Reformatore Demokratike | PRDSH | Skender Halili |
| 17 | Partia Rruga e Lirisë | PRRL | Shukrane Muda |
| 18 | Partia Socialdemokrate | PSD | Skender Gjinushi |
| 19 | Partia Socialiste e Moderuar | PSM | Gjergj Koja |
| 20 | Partia Socialiste e Shqipërisë | PSSH | Edi Rama |
| 21 | Partia Socialiste e Vërtetë 91 | PSV 91 | Petro Koçi |
| 22 | Partia Toleranca e Re e Shqipërisë | PTR | Avdi Keci |

### KOALICIONI

Në përfundim të takimit kreu i PSD Skënder Gjinushi deklaroi se, u diskutua mbi rrugën që do të ndjekë opozita shqiptare për të hyrë në fushatën elektorale për zgjedhjet e 23 qershorit. Duke folur mbi numrin e partive që do të futen në koalicion Gjinushi u shpreh se, nuk ka shumë rëndësi numri i partive, sesa fryma e bashkëpunimit. "Ky është fillim i mbarë. Tashmë e rëndësishme është që opozita ka një platformë bindëse. Më pas do diskutohet edhe marrëveshja për formën e bashkëpunimit. Ka një marrëveshje për të realizuar fitoren në zgjedhje dhe një për të qeverisur vendin në zgjedhjet e ardhshme", tha Gjinushi. Ndërsa kreu i PSV 91, Petro Koçi, theksoi se, "riaktivizimi i koalicionit me rreth 30 parti është mjaft i mirë për Shqipërinë, sepse ka të bëjë e objektivin për të fituar zgjedhjet". Sipas tij, boshti i këtij koalicioni do jetë rikthimi i politikës tek ndërgjegjja kombëtare që kërkojnë qytetarët. "Mendoj se ka parti politike që s'është e nevojshme që të japin përgjigje tani për koalicionin. Të cilat në momentin e duhur do ta shohin të logjikshme për të vendosur për koalicionin, duke bashkëpnuar nëpermjet integrimit në koalicion, apo nëpërmejt formave të tjera politike" tha ai, duke nënkuptuar FRD dhe AK. Ndërsa kreu i PLD, Spartak Ngjela u shpreh se, "është vendosur të rritet spektri i partive të koalicionit, ka arritur 30 dhe mund të rritet akoma. Por çështja është tek fushata elektorale. Çdo njeri duhet të dijë të bëjë fushatë elektorale dhe duhet të jetë krijues për mbrojtjen e votës. PD i kanë rënë aksionet, por ne duhet të ruajmë votat. Kemi bërë një skemë perfekte për ruajtjen e votës. Do na duhet një marrëveshje bilaterale që do e bëjë kreu i PS me secilën parti. Është një frymë për fitore nga ky koalicon. Duhet të jesh i aftë të shfrytëzosh këtë mendim që ka opinion se fitohet majtas". Ngjela theksoi se, "duhet të fillojë një fushatë shumë e mirë, në të gjitha poret e shoqërisë. Duhet të dalë formula, ose platformë për dalje nga kjo gjendje e rëndë. Kjo është kriza nga e cila do e nxjerrë shoqërinë opozita". "Nuk ka drejtësi, ka krizë në treg, nuk funksionon kapitalizmi, ka krizë morale shoqëria. Duhet të ngremë humanitetin që ta ngremë shoqërinë nga kjo krizë morale", tha Ngjela.

**"Ka dy qëndrime, për të realizuar fitoren dhe për të qeverisur vendin për 4 vitet e ardhshme".**

## Arvizu takim me Topin: T'u rezistohet tundimeve nacionaliste

**Ambasadori Amerikan, Alexandër Arvizu, deklaroi se SHBA mbështet integrimin në strukturat euro-atlantike të Ballkanit Perëndimor, por apeloi kujdes për cështjet etnike. Pas një takimi që pati me kreun e FRD, Bamir Topi, Arvizu theksoi se pjesë e rëndësishme është dialogu, Prishtinë-Beograd. "Sikurse e dinë të gjithë SHBA mbështesin të gjithë anëtarësimin në strukturat euro-atlantike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Dhe nga të gjitha pjesët e lëvizshme, ajo që është më kritikja dhe më e rëndësishmja është pjesa e dialogut, Prishtinë-Beograd. Prandaj është e rëndësishme ta mbajmë këtë në lëvizje, në drejtimin pozitiv", tha ai. Sipas ambasadorit amerikan, interesi për shqiptarët etnikë prodhon retorika nacionalistë që kthehen në rrezik për integrimin. Arvizu kërkon vetëpërmbajtje pasi përpara janë zgjedhjet. "Prandaj është e rëndësishme të mund t'i rezistohet tundimit që të përfshihen në retorikë nacionaliste, veçanërisht në klimën e zgjedhjeve, pasi kjo vetëm shërben se mund të shpërqëndrohemi nga qëllime më të rëndësishme, që janë qëllime që të gjithë shqiptarët i bashkëndajnë".**



### KQZ, Biba:

# "Ministria e Brendshme pasaportizim në Kukës për të mos hequr një mandat"

TIRANE

Nënkryetari i KQZ-së Denar Biba lëshon akuza të forta mbi institucionin e Ministrisë së Brendshme se transferoi me pasaportizim një pjesë të mirë të administratës, përfshirë këtu edhe policë, në Qarkun e Kukësit në mënyrë të tillë që këtij qarku të mos i hiqej një mandat. Ai tha se nuk ka asnjë tërheqje, por tani anëtarëve të KQZ iu është vënë në dispozicion nga dy auditues prranë Gjendjes Civile sqarimi për lëvizjet fiktive të popullsisë në Kukës, rritja e së cilës i dha këtij qarku të drejtën të mbajë deputetin e katërt. "Del qartësisht që lëvizja ka qenë e manipuluar drejt Kukësit. Qytetarë të Tiranë,kryesisht punonjës të Ministrisë së Brendshme, janë të detyruar të shkëpusin gjendjen e tyre civile nga Tirana dhe të regjistrohen në Topojan apo Shishtavec, në mënyrë të palogjikshme, por ligjore. Formalisht këta njerëz janë regjistruar dhe kanë një certifikatë nga komuna Topojan apo Shishtavec, moralisht kjo është një lëvizje e dënueshme. Këtu mund të ketë nevojë për hetim më të thelluar, por jo nga KQZ-ja", thotë Biba. Ai thotë se angazhimi i Kuvendit për të bërë ndarjen e mandateve, është antikushtetues dhe antiligjor. Përveç se formalisht akti i është dërguar Kuvendit nga sekretarja e KQZ-së, ndërsa ligji kërkon që ai të çohet nga kryetarja me firmën e nënkryetarit, Denar Biba vë në dukje pasojën e rrezikshme që do të vijë sipas tij, nëse nuk bëhet një rindarje e re e mandateve. "Në rast se do të ndodhë ashtu, atëherë nesër, pasnesër në përfundim të zgjedhjeve, cilido që të jetë fituesi i tyre, do të mjaftonte çdolloj subjekti që të shkonte në Gjykatën Kushtetuese dhe me një garanci shumë të lartë, Gjykata Kushtetuese do të shpallte të pavlefshme zgjedhjet dhe do të detyronte ripërsëritjen e tyre. Nuk mund të cënohet barazia e votës", thotë Biba.



Denar Biba, zv/kryetari i KQZ

KOALICIONET, DEBATI

### Kusht për aleancën me PS, Dule: Jo në një grup me AK e PDIU

# Idrizi: Qëndrimi i Dules ngjan me "Agimin e Artë"

## *"Po t'i kërkohej zgjedhje PDIU, preferencë për AK"*

TIRANE

JAKIN MARENA

Debate të forta kanë shpërthyer mes kreut të të Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi e kreut të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Vangjel Dule. Shkak është bërë një deklaratë e Dules, i cili përjashton çdo koalicion me grupime politike të cilat kanë në përbërje si aleatë të saj, PDIU dhe Aleancën Kuq e Zi. Ndërkohë që ka ardhur dhe përgjigjia e fortë e kreut të PDIU, Idrizi i cili nuk ka munguar të kujtojë se një qëndrim i tillë i Dules s'ka të bëjë me vlera evropiane e për më tepër ngjan me deklaratat e partisë neonaziste greke. Njëherësh ka paralajmëruar se preferencat e tij për koalicione parazgjedhore. "Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut mbetet e palëkundur në qëndrimin e saj për të mos bërë koalicion me parti të cilat kanë probleme të rënda demokracinë dhe shtetin e së drejtës", është shprehur kreu i PBDNJ, Dule në një prononcim për "AS", lidhur me koalicionet e mundshme për zgjedhjet e qershorit. Dule i është referuar Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet dhe Aleancës Kuq e Zi, duke i bërë thirrje dhe partive të tjera që mos të mos bashkëpunojnë me forca të tilla. "Është e njohur publikisht se PBDNJ nuk do të bashkëpunojë me forcat politike të cilat kanë probleme me vizionin europian dhe me demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Rjedhimisht nuk ka hapësirë bashkëpunimi të PBDNJ me kategori të tilla forcash politike. Por kjo nuk do të jetë prioritet vetëm i PBDNJ, është një aspekt tejet negativ i jetës politike të vendit tonë, ku forca serioze politike, qeverisëse, siç janë PS e PD flirtojnë për bashkëpunime me forca të tilla politike të cilat cënojnë rëndë profilin europian të sistemit tonë politike dhe situatës politike", thotë Dule, kreu i PBDNJ. Por i menjëhershëm ka qënë reagimi i kreut të PDIU, Shpëtim Idrizi që ka preferuar të jetë shumë konciz në deklaratën e tij sqaruese për deklaratën e liderit të PBDNJ, Vangjel Dule. "Ky është një qëndrim aspak dinjitoz e aspak evropian. Ky qëndrim më ngjan me qëndrimin e "Agimit të Artë". Por, nëse do të kishte mundësinë që PDIU të zgjidhte mes PBDNJ dhe Aleancës Kuq e Zi, ajo do të zgjidhte padyshim Aleancën Kuq e zi", ka qënë deklarata e Idrizit për gazetën "Shqiptarja.com". Duke paralajmëruar në këtë mënyrë se nuk përjashton mundësinë e një koalicioni me AK e Spahiut. Ndërkohë kreu i PBDNJ Dule sërish ka këmbëngulur ku ka bërë të ditur se deri më tani, forca që ai drejton është duke diskutuar me të gjitha forcat politike, duke mos i mbyllur derën asnjë force politike. Një deklaratë të cilën e ka thënë dhe më parë për gazetën tonë, teksa ka nënvizuar se "mblesët" nga të dy partitë e mëdha, PD dhe PS nuk kanë munguar për ta joshur për koalicion parazgjedhor, përmes premtimeve konkrete por që deri më tani ende s'ka dhënë asnjë qëndrim. Ndërkaq, ai foli dhe për votën që do japë në Parlament lidhur me ndarjen e mandateve. "Votimi do të jetë gjithmonë konform ligjit dhe nuk duhet të karakterizohemi nga fryma e krijimit të dritareve në vendimmarrje legjislative, nga të cilat do të mund të përfitojë PBDNJ, ose ndonjë parti tjetër. Duhet të shihet ajo çka është e drejtë, ajo çka është ligjore", tha Dule. I pyetur lidhur me një bashkëpunim të mundshëm me partinë MEGA, e cila gjithashtu mbron të drejtat e minoritetit, Vangjel Dule ka deklaruar se PBDNJ nuk i ka mbyllur derën asnjë force politike dhe aq më shumë një partie e cila ka në themel të njëjtin program, duke lënë të kuptohet se janë gati për një gjë të tillë.



Shpëtim Idrizi



Vangjel Dule

### Akuza

"Aspekt tejet negativ i jetës politike të vendit tonë, ku forca serioze politike, qeverisëse, siç janë PS e PD flirtojnë për bashkëpunime me forca të tilla politike që cënojnë rëndë profilin european të sistemit tonë politike dhe situatës politike".

## Çertifikohen auditorët e trajnuar të eficiencës energjetike

**Në kuadër të Programit "Zhvillimi i Kapaciteteve Njerëzore", të financuar nga Qeveria Gjermane, GIZ-Shoqëria Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar, ka në nëntor-dhjetor 2012, 14 auditorë të eficiencës së energjisë në ndërtesa. Objektivi i këtij trajnimi, i cili do të pasohet edhe me trajnime te tjera gjatë vitit 2013 për tema të ndryshme të eficiencës së energjisë, ishte rritja e kapaciteteve njerëzore të inxhinierëve dhe arkitektëve të sektorit privat dhe atij publik për kryerjen e auditimeve energjetike në ndërtesa, sipas standardeve të Komunitetit Evropian, të cilat do të bëhen të detyrueshme edhe për vendin tonë në muajt e ardhshëm, me miratimin e Ligjit për Eficiencën e Energjisë. Ismail Beka, zv.drejtor i zyrës së GIZ në Tiranë, nënvizoi rëndësinë e këtij projekti. "Ky trajnim është një hap më tej në realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Energjisë përsa i përket eficiencës së energjisë dhe të procesit të implementimit të legjislacionit përkatës sipas standarteve të BE".**

### Kreu i PSD jo ndarjes së mandateve në Kuvend. Akuza për shkelje Kushtetute

# Gjinushi: Opozita fiton mbi 60 përqind pa LSI

## *"Berisha tenton skemën e manipulimit në qershor, si Tiranë 2011"*



*Lajmi*

**Kreu i PSD Skënder Gjinushi është shprehur kundër ndarjes së mandateve në Kuvend, pais ky është tagër i KQZ. Ai thotë se opozitarët duhet të bashkohen për largimin e kësaj qerverie dhe se opozita pa LSI merr mbi 60 përqind të votave të qershor.**



**Koalicionet**

"Një gjë duhet të kemi të qartë, nëse disa thonë se kemi frikë se çahet e majta, atëherë ne i bëjmë të qartë çdo të majtë që vota për LSI është votë për Sali Berishën. Tani nuk ka nevojë ta thotë as Nano e as Rama, këtë e thotë vetë Meta, e thotë vetë kjo përvojë 8-vjeçare".

TIRANE

JAKIN MARENA

Kreu i PSD Skënder Gjinushi në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" flet mandatet dhe aleancat parazgjedhore.

**Opozita rikthehet për ndarjen e mandateve në skemën e parë të cilën përmes përfaqësuesve të saj në KQZ e kishte rrëzuar. Cila është skema e opozitës për të evituar...?**

Ne denoncojmë me forcë atë çka tenton të bëjë Kuvendi. Këto janë veprime antikushtetuese dhe antiligjore, sepse Kuvendi nuk vihet në lëvizje me letra. Eshtë e njejta skemë si vjedhja e Tiranës në zgjedhjet e 8 majit. Ku KQZ me një letër nga PD vendosi të kryejë veprime në kundërshtim të hapur me Kodin. Dhe tani Kuvendi me një letër nga "Jozefina3", vartësja e vartëses së Jozefinës në KQZ kërkon të marrë një vendim për diçka që s'ka asnjë tagër ligjor. Ligji është shumë i qartë: Kuvendi miraton propozimet e KQZ. Kur s'ka propozim s'ka miratim. Do të ishte njëlloj sikur të zgjidhje anëtar të Gjykatës së Lartë apo Kushtetueses pa propozimin e Presidentit, meqënëse Presidenti s'do që të propozojë atë që do ti. Pastaj personi i drejton një letër kuvendit, e ai për të mbajtur një qëndrim konstruktiv siç shprehet Uollfarth, i thotë Kushtetutës e ligjit që ju jeni destruktivë dhe në Evropë shkohet sipas vullnetit arrogant të shumicës.

**"Kuvendi miraton propozimet e KQZ, s'ka propozim, s'ka vendim. Përfunimisht zgjedhje legjitime ka vetëm duke shpërndarë mandatet sipas lëvizjeve të fundit demokratike, me pesë votat pro të KQZ"**

**Si zgjidhet...?**

Nëse mandatet caktohen në rrugë të paligjshme, do thotë që vetë zgjedhjet janë të paligjshme. S'është si manipumimi me votë, loja me karta identiteti, që shkalla e shkeljes varet se sa është, e në bazë të tyre raportet cilësojnë nëse në tërësi zgjedhjet janë legjitime ose jo. Ndërsa këtu bie legjitimiteti i zgjedhjeve. Ligji ka dy detyrime themelore, rishikimin e shpërndarjes së mandateve para çdo fushate zgjedhore, sepse kanë kaluar 4 vjet dhe ka lëvizje demokrafike. Çka do thotë që vetë ligji ndarjen e mëparshme e quan nul pasi ishte bërë për atëherë. Dhe e dyta, që këtë rishikim e bën KQZ dhe ajo e ka të drejtën e propozimit në Kuvend. Kuvendi pastaj vetëm ratifikon propozimet e KQZ. Ndërsa mosrishikimi i shpërndarjes do thotë të shkelësh hapur barazinë e votës, të drejtën e përfaqësimit në mënyrë të barabartë, sepse si kuksianët, si beratasit, si tiransit dhe të gjithë qytetarët kudo duhet të përfaqësohen në mënyrë sa më të barabartë në Kuvend.

**Mendoni se është një skemë manipulimi kjo...?**

**Në foto:** **Skënder Gjinushi dhe Petro Koçi** *(lart djathtas)* **KQZ gjatë një mbledhjeje** *(poshtë)* **Kreu i PS-së, Edi Rama**

Është fiks skema e manipulimit në Tiranë ku përdhunisht nuk respektohet marrja e vendimit me 5 vota dhe çuditërisht i pari që rend për të justifikuar këto shkelje është ambasadori i OSBE. Shqiptarët këto ditë po shohin të njejtët skenarë, të njejtët protagonistë, të njejtat lojëra politike dhe të tëra këto kërkohet të kalohen me ca fraza të çuditshme që siç ishte për Tiranën që çdo votë duhet numëruar, por mënyrën se si numërohet e përcakton shumica dhe jo Kodi. Dhe tani thuhet që nuk mund të ketë bllokim dhe zhbllokimi gjendet te arbitrarizmi i shumicës në kundërshtim me ligjin. Po pse fakti që nuk arrihet votimi me pesë vota pse quhet bllokim i pakicës dhe jo bllokim i shumicës? Po të ndiqej kjo rrugë atëherë i bie që sa herë s'miraton dot një ligj në Kuvend ta çoje në gjykatë e ta bën gjykata ligjin siç bëri me ZAZ. KQZ ka kompetencat e saj dhe askush nuk e zëvendëson atë dhe aq më shumë s'mund ti bëjë këto as në emër të kontruktivitetit e as në emër të zhbllokimit. KQZ duhet të përcaktojë shpërndarjen e mandateve, që s'ekziston. I vjetri ka mërdhirë, ka përfunduar me zgjedhjet e 2009 e s'ka vlerë për zgjedhjet e tanishme. Duhet të bëhet në rrugë legjitime.



**Përfaqësuesit e PS në KQZ i janë rikthyer variantit të parë...?**

Unë di që me të drejtë ka pasur debate në KQZ, që janë manipuluar banorët e Kukësit hapur. Pavarësisht nga shkalla e pjellshmërisë, ajo nuk ndodh në tre muaj. Dhe sepse pjellshmëria e jep efektin elektoral pas 18 vjetësh, nuk e jep menjëherë. Pra nëse ka pasur ndonjë lulëzim nga Rruga e Kombit, pra janë shtuar lindjet nga qejfi i rrugës ato e japin efektin pas 18 vjetësh. Lindshmëritë në Shqipëri kanë rënë në mënyrë drastike dhe në mënyrë uniforme në të gjitha zonat në tërësi. Për hir të vërtetës në zgjedhjet e vitit 2009 kur PD shtoi votues kudo, vetëm në Dibër, Kukës dhe Gjirokastër nuk kishte asnjë shtesë. Tani çuditërisht papritmas dhe kjo shtesë nuk mund të shpjegohet. Pra manipulimi ishte i qartë sepse ka ndodhur vetëm në një periudhë disamujore, është shumë e lokalizuar vetëm në disa komuna dhe nuk ka nevojë për investigim për të kuptuar lojën. Por dhe që në Shqipëri dihen gjërat, janë rikthyer formalisht shumë persona dhe për pasojë KQZ kishte të drejtën absolute që të kërkojë shpjegime sepse ajo ka të drejtën të zbatojë ligjin për shpërndarjen e mandateve sipas numrit të popullsisë. Këta në vend që të bëjnë transparencën për këtë çështje, tentojnë ta bëjnë përmes Kuvendit. Kur Kuvendi absolutisht i ka duart e lidhura. S'ka asnjë nen, asnjë paragraf që i jep të drejtë Kuvendit të bëjë shpërndarjen e mandateve.

**Cila është skema e opozitës që do të maksimalizonte votën që të garantohej fitorja pa një aleancë me LSI apo partitë e reja...?**

Nuk ka parullë më bajate, më pa sens, më pa moral dhe më absurde se sa ajo që thotë se "a do të fitojë opozita pa LSI". Opozita ka 8 vjet që kërkon të ndryshojë këtë realitet të hidhur shqiptar, mbështetur nga shumica dërmuese e popullit shqiptar. Me shpirt nëpër dhëmbë, me gjithë deformimet e sistemit opozita me 2009 arriti që me votë popullore ta mundë këtë qeveri. Por ishte pikërisht LSI që për herë të dytë, tashmë del hapur, dhe i jep mandatet për të qeverisur dhe 4 vjet të tjera, mandate që ishin marrë për të shkulur këtë qeveri. Pas kësaj PD-LSI del qartazi se i ka bashkuar korrupsioni, që është shumëfishuar dhe ka thyer çdo lloj rekordi, të çdo lloj qeverie të mëparshme, dhe të Berishës së '96-'97 me Piramidat, edhe ato që Berisha thoshte për Nanon apo dhe vetë Metën para se të bëhej pjesë e kësaj qeverie. Kjo qeveri ka dështuar tre herë radhazi për integrimin. Dhe është qeveria më e çuditshme në botë, fajin ia ka opozita që "dështon". Por dështimi e ka emrin korrupsion, zgjedhje jashtë standardeve, antikushtetutshmëri dhe drejtim Kuvendi alla-Jozefinë.

**Fitoni si bllok i majtë...?**

Absolutisht gjithë populli opozitar kërkon largimin sa më parë të kësaj qeverie, të këtij çifti Berisha-Meta, PD-LSI apo siç e kanë quajtur njëri tjetrin Sali 'Gërdeci' me Ilir 'Floririn'. Kanë gjetur mënyrën më të mirë për të personifikuar njëri tjetrin. Dhe në këto 4 vite që të dy e kanë pasuruar këtë tipar të tyre. Pas Gërdecit bëri 21 janarin, pas 21 janarit deklaron se jam gati të vras dhe kryetarin e opozitës e

## Ligji në Kuvend rrëzon Berishën për hapësirë të përbashkët

Gjatë seancës së të enjtes Ligji për mediat audiovizive që është duke u shqyrtur në Komisionin e Medias hedh poshtë deklaratën e kreut të qeverisë Sali Berisha për krijimin e një hapësire të përbashkët shqiptare për valët e transmetimit televiziv, ku radio-televizioni shqiptar duhet t'u krijojë lehtësira mediave të Kosovës për vendosjen e repetitorëve për transmetim. "Transmetuesit publikë të gjitha kapacitetet teknike ia vë në dispozicion operatorëve komercialë privatë kundrejt tarifave të shërbimit në mënyrë transparente dhe konkuruese, që do të thotë se të gjithë në treg do të jenë të barabartë dhe përsëri këtu transmetuesi publik është i pavarur nga vendimmarrja e qeverisë. Ligji i jep edhe deklaratës së kryeministrit që ka qenë një deklaratë tërësisht për konsum politik, tërësisht klienteliste", deklaroi deputeti socialist. Deputetët kanë diskutuar kapitullin mbi menaxhimin e Radio-televizionit Shqiptar dhe pavarësinë që ai duhet të ketë, një pikë e debatueshme mbetet pavarësia editoriale por edhe transparenca në cështjet e financimit. Mark Marku tha se RTSH duhet të ketë debat politik, por jo propagandë politike.



gjithkënd që kërkon dorëheqjen e qeverisë sime. Opozita sot ka këtë detyrë, të çmontojë këtë qeverisje, që ka emra, qeverisja nuk është fenomen natyror, ka përgjegjës, ka protogonistë dhe të thuash se a e heqim këtë qeveri pa ndihmën e kësaj qeverie, këtë unë nuk e kuptoj dot. Dhe që nga ky moment roli ynë është që të mos mashtrohet kurkush që të votojë për LSI që ajo mund të jetë me të majtën. Ky është një mesazh krejtësisht i gabuar që s'duhet të ndodhë. Ky është dhe një nga defektet e pyetjeve nëse do vijë LSI majtas. Ku LSI është përgjegjësja numër një e keqqeverisjes së këtij vendi. Prandaj koalicioni i majtë absolutisht nuk e ka në llogari LSI-në. Ca më shumë dhe sikur të kishte ikur me të vërtetë nga qeveria më parë dhe për çështje në dukje parimore dhe jo për lojë, përsëri nuk i besohet që nesër nuk shkon në krahun tjetër. Këtë radhë i thonë ta kruash vetë. Sepse ta punoi më 2005, më 2009, ta punoi me Presidentin dhe po e provove prap, ti qofsh. S'është faji i LSI, pasi ai e ka treguar se e ka këtë ves. Prandaj llogarija është që grupimi i majtë të fitojë votat e të gjithë atyre që duan këtë ndryshim, atyre që s'pajtohen me këtë realitet dhe të gjithë atyre që s'pranojnë më qeverisjen PD-LSI. Në Shqipëri ka 60% që votojnë kundër kësaj qeverie, nga të cilët mbi 50% janë me të majtën. Ndaj e majta është e vetëmjaftueshmë për të fituar e ka fituar gjithmonë. Por të majtën e kanë shitur e shyqyr që u pastruam nga ata që shisnin të majtën. Prandaj PSD nuk është dakord që të eksperimentojmë përsëri me atë që na shet e roli ynë është që ti bëjmë të qartë gjithkujt që vota për PSD, për PS çon në fitore e ndryshim real, kurse çdo votë jashtë këtij grupimi s'është për të majtën. Aq më tepër që çdo votë për LSI s'është për të majtën por për Berishën.

**"Ndërsa sigurisht LSI ka vazhduar e me ç'dëgjon ky popull qoftë për KESH, qoftë për krom, apo për naftën kanë kaluar edhe vlerën e floririt të vjedhur në Krrabë", thotë Gjinushi për qeverisjen.**

### Debate në Komisionin e Sigurisë, Noka raporton në 5 shkurt

# PS: Ushtria në funksion të fushatës së PD-së

## *SHISH pushon 24 punonjës, rikthen të `97-ës*

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Opozita në Komisionin e Sigurisë hodhi dyshime të forta se agjencitë e inteligjencës po përdoren për të manipuluar zgjedhjet e 23 qershorit. Nënkryetari i komisionit, Ilir Gjoni kërkoi thirrjen në seancë urgjente të shefit të SHISH dhe te agjencisë pranë Ministrisë se Mbrojtjes. "Nuk e kuptoj ministrin e Brendshëm se ditën që ndërroi jetë komisari i Burrelit të deklaroj se Shqipëria është vedi më i sigurt. Ju qofshi sesi e pranoni. Një prej kolegëve tanë u bë 4 vjet që ka humbur jetën. Duhet të kishim ngritur nënkomisionin për mbikqyrjen e institucioneve. Kemi fakte që këto institucione po përdoren për fushatë", tha Gjoni. Gjithashtu socialisti Piro Lutaj denoncoi përdorimin e mjeteve ushtarake ne komunat e drejtuara nga demokratët, për të ndikuar në fushatën elektorale. Komisioni i Sigurisë ka parashikuar seancë dëgjimore për situatën e rendit në vend, në 5 shkurt me ministrin Flamur Noka. Të majtët thanë se krimi po mbizotëron kudo. Por opozita ka vënë alarmin edhe për situatën e furnizimit me energji, e cila sipas PS, është e gjitha në duart e kompanive serbe.



### Ekstradimet në serbisht

Qqeveria dërgon në Parlament një marrëveshje me Kosovën për ekstradimet, në 2 gjuhë, duke përfshirë edhe serbishten. Socialisti Arben Isaraj, tha se kjo është e pakuptimtë. Por përfaqësuesja e ekzekutivit tha se serbishtja ishte përdorur me kërkesë të palës kosovare.

### DEBATE NË KOMISIONIN E SIGURISË

**Qefalia:** Cila ka qenë indicia që është bërë një marrvëeshje e tillë me Kosovën dhe a keni statistika për personat që do ekstradohen, të cilët vuajnë dënimin në Kosovë dhe anasjelltas.

**Ministria e Mbrojtjes:** Fatëkeqësisht ne nuk kemi statistika për numrin e të dënuarve në Kosovë.

**Isaraj:** Pse këto dy marrëvëshje janë bërë në dy gjyhë në shqip dhe në serbisht?

**Ministria e Brendshme:** Gjuha serbe është gjuhë zyrtare në Kosovë. Është kërkuar nga pala kosovare që marrëvesja të hartohet në të dy gjuhët.

**Gjoni:** Situata e rendidt dhe sgurisë është katastrofike. Nuk e kuptoj ministrin e Brendshëm se ditën që ndërroi jetë komisari i Burrelit të deklarojë se "Shqipëria është vedi më i sigurt". Ju qofshi sesi e pranoni. Në aspektin human është e papranueshme. Ne nuk mund të pranojmë deklaratat sikur këtu është Zvicër, Gjermani e ku ndërkohë që kronikat e zeza të mediave janë të mbushura me lajme nga më të hidhurat përsa i përket sigurisë. Kemi kërkuar minsitrin e Ekonomisë për të na raportuar për Alpetrolin,por mbi politikat energjitike në vend. Duhet të kishim ngritur nënkomisionin për mbikqyrjne e institucioneve. Kemi fakte që këto institucione po përdoren për fushatë. Një nga problemet e tjera është dhe emërimi i njerëzve në funksione të rëndësishme shtetërore. Si mund të shpjegohen sot purgjet që po bën dhe po ndjek drejtori i ri i SHISH, jo më larg se tre ditë më parë ai ka shkarkuar nga detyra 24 vetë, pa përmendur rastet e mëparshme. Çështje më e keqja, po rikthehen në detyrë disa figura që kanë qenë të implikuara në ngjarjet e '97.

**Demi:** Institucionet e sigurisë të vendit tonë po punojnë jo për të dëmtuar zgjedhjet, por për të garantuar zgjedhje sipas standardeve Europiane. Prandaj zoti Gjoni shqetësimet e juaja politike mendoj mos i ngrini këtu për fushatë, por kur të bëni fushtë elektorale.

**Lutaj:** Po them që institucionet e sigurisë po i vendosni në funksion të fushatës elektorale dhe mos të të vij keq se po ta them që mjete të ushtrisë shqiptare po vihen në dispozicion të komunave dhe qarqeve që administron PD-ja.

**Kemi fakte që këto institucione po përdoren për fushatë. Si mund të shpjegohen sot purgjet që po bën dhe po ndjek drejtori i ri i SHISH, jo më larg se tre ditë më parë ai ka shkarkuar nga detyra 24 vetë.**

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve,
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan
Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com

## Clinton letër Edi Ramës: Kënaqësi takimi me ju në Tiranë



**Kryetari i PS, Edi Rama publikoi në rrjetin social "Tëitter" një letër që ka mbërritur në adresë të tij nga sekretarja amerikane e shtetit, Hillary Clinton. "I nderuar Zoti. Rama! Ishte një kënaqësi që u takuam në Tiranë. Jam e kënaqur nga diskutimet që patëm rreth Shqipërisë dhe lidhjeve historike mes dy shteteve tanë. Ju falenderoj gjithashtu edhe për emblemën prej argjendi me shqiponjën dykrenare. Ky simbol i rëndësishëm shqiptar do mbtetet një kujtim shumë i mrekullueshëm i vizitës sime në Tiranë". Kështu shkruan në letrën e saj, Hilari Klinton dërguar kreut të selisë rozë Edi Ramës. Kreu i PS e ka ndarë këtë moment me ndjekësit e tij në rrjetin social twitter, ku shkruan "kënaqësi fort e posaçme kur një ditë, për më tepër me shi, nis me një letër si kjo mbi tryezën e punës".**

### Akuzat për Linda Bashën dhë fëmijët e Berishës do verifikohen

# 21 janari si 1997-ta përgjegjësit para ligjit

## Të shkrihet Prokuroria e Krimeve të Rënda

*Lajmi*

**Kryeprokurori Llalla foli për hetimet e ngjarjes së 21 janarit, ndëshkimet për pjesmarrësit si dhe qëndrimin e ndërkombëtarëve në këtë ngjarje. Ai sugjeron që të shkrihet Prokuroria e Krimeve të rënda.**

TIRANE

SOKOL BALLA

Në një intervistë për "Top Story", kryeprokurori i Përgjithshëm, Adriatik Llalla bëri të ditur se nuk mund të fillojnë hetime për 21 janarin bazuar në deklaratat e partive politike. Duke e krahasuar ngjarjen me `97, Llalla bëri të ditur se ajo ishte përgjegjegjësi e pjasmarrësve. "Këto janë situata që në Shqipëri janë përsëritur shpesh gjatë këtyre 20 viteve dhe të krijojnë një përshtypje jo të mirë. Unë personalisht në vitin 1997 kam filluar punë për herë të parë në qytetin e Lushnjes, ku gjeta një qytet të shkatëruar nga trazirat e atij viti. Ajo (21 janari) ishte një ngjarje e rëndë që ndodhi në mes të kryeqytetit me ato pasoja të rënda me atë mënyrë që u organizua dhe gjykoj se ishte përgjegjësi e të gjithë atyre që morrën pjesë në këtë ngjarje.Vetëm me deklarata publike ne nuk mund të rifillojmë hetimet pa patur të dhëna konkrete lidhur me këtë rast. Në datën 30 Prokuroria do të japë konkluzionet e saj përfundimtare lidhur me personat që akuzohen për këtë vepër penale", tha ai. Ai shtoi se vendi ynë nuk ka situata ekstreme për të patur një organ të tillë siç është ai i Prokurorisë së Krimeve të Rënda. "Ajo prokurori ka patur rezultate të mira gjatë kësaj periudhe. Puna është vlerësuar pozitivisht si nga fajtorë ndërkombëtarë që mbështettën krijimin e saj. Megjithatë në bindjen time në shqipëri nuk është një situatë kaq ekstreme sa të kemi struktura të tilla për të ndërtuar prokurori apo gjykata të kësaj natyre", tha ai. Ai shtoi se organi i akuzës është duke hetuar zyrtarë të niveleve të larta në vend, kjo pas denoncimit të bërë nga qytetarët. "Ka zyrtarë të nivelit të lartë të cilët denoncohen nga qytetarët dhe për të cilët ka filluar hetimet, hetime të cilat mund të heen publike në ditët në vijim", tha ai. Ndër të tjera ai shtoi se në organin e akuzës janë depozituar kallëzime penale përsa i përketë akuzave të mazhorancës në drejtim të bashkëshortes së Edi Ramës, ku tha se janë duke u verfifikuar provat dhe më pas do të ketë një vendim për fillim hetimi apo jo.


Adriatik Llalla

### Blog/ Periferi

# Nga Shqipëria 1 Euro, te Shqipëria pa rregulla



NGA ALBA MALLTEZI

Kur flitet për mungesë rregullash dhe mungesë drejtësie në një Shtet, për ç'formë Shteti flitet? Kohët e fundit, po shtohen përditë zërat e shqetësimit të mosfunksionimit të Shtetit në Shqipëri. Kur rregullat shkelen dhe nuk ka asnjë gjykatë për të kërkuar drejtësi, rreziku është i paimagjinueshëm. Mungesa e sigurisë tremb biznesin, motorin e rëndësishëm të gjenerimit të mirëqënies për një vend.

Biznesi që është mik i pushtetit, nuk ka asnjëherë asnjë kontroll tatimesh, bën evazion, kalon doganat pa asnjë vështirësi, duke krijuar pabarazi të tregut. Kush kërkon të punojë në respekt të rregullave, papritur gjendet në vorbulla kërcënuese. Alarmin tashmë e kanë hedhur të gjithë: jo vetëm opozita, jo vetëm shqiptarët, por edhe të huajt. Dhoma amerikane e Tregtisë, ambasadorja Gjermane në Shqipëri, ambasadori Italian në Tiranë. Në Shqipëri sot nuk ka rregulla të qarta. Lëngon Shteti i së drejtës.

Kryeministri Sali Berisha, e nisi rrugën e tij në pushtet duke premtuar klimë shumë të mirë për bizneset, por rregullat e lojës ndryshohen përditë. Sot mund të themi se e gjithë Qeveria është në shërbim të krijimit të një klime të mirë vetëm për dikë që mund të quhet Damir Fazlliç, apo 3-4 biznesmenë që janë të besuarit e pushtetit dhe klientë të tij.

Ambasadori Italian në Tiranë, Massimo Gaiani, është një person i rezervuar. Diplomacia e tij ka klas, matet shumë herë të thotë një gjë që mund të konsiderohet si ndërhyrje në politikën e brendshme të vendit, por në intervistën e tij të fundit dhënë për A1Report dhe Shqiptarja.com foli hapur: *"...Ka mjaft interes në Itali për të investuar në Shqipëri. Por të gjithë operatorët ndjejnë domosdoshmërinë e rregullave, e respektimit të pagesave, të funksionimit të plotë të drejtësisë. Me një klimë të favorshme biznesi, që kërkon edhe një mjedis industrial të përshtatshëm, pra furnizim të rregullt me energji elektrike, një rrjet shitjesh si dhe elementë të tjerë, mendoj se mund të përmbyset gjendja dhe mund të shfrytëzonet kriza. Krizat e thella ekonomike, si ajo që po përjetojmë, ofrojnë edhe mundësi të tjera sepse ekonomia rrezikon të ndalet. Shqipëria mund të përmbushë nevojën e Italisë për punëtorë të kualifikuar dhe me kosto të ulët, në një mjedis shumë të ngjashëm me realitetin italian dhe në një vend ku flitet gjerësisht gjuha italiane. 50% e shqiptarëve flasin italisht. Është një fenomen shumë i rëndësishëm që Shqipëria mund të shfrytëzojë, së bashku me faktorët e tjerë që lidhin dy vendet tona. Ka shumë mundësi zhvillimi. Shumë sipërmarrës që i drejtohen tregut të Kinës dhe Lindjes së Largët mund të jenë të interesuar për tregun shqiptar. I takon Shqipërisë të përthithë këtë interes, duke siguruar kushtet e domosdoshme...."*

Çfarë po ndodh realisht? Të kujtojmë edhe shqetësimin e ambasadores gjermane Carola Müller-Holtkemper. Në një intervistë dhënë për radion Dojçe Vele pak kohë më parë, e që kaloi pa shumë jehonë në mediat shqiptare, edhe ajo ngriti një problem shumë shqetësues e që kërkon vëmendje. Ja çfarë tha:

*"...Sektorët kryesorë, ku përqendrohen projektet tona të dakorduara bashkarisht me qeverinë shqiptare janë energjia, ujësjellës / kanalizimet, mbështetja për sipërmarrjet e vogla e të mesme dhe qeverisja e mirë. Këto janë projekte me impakt pozitiv të drejtpërdrejtë në popullsinë shqiptare. Kënaqësia jonë për këtë bashkëpunim të gjatë e të frytshëm trazohet disi nga konstatimi i përpjekjeve në rritje për t'iu shmangur detyrimit të dakorduar në Marrëveshjen Kuadër për shkarkimin nga tarifat doganore, tatimore dhe tarifave të tjera. Karshi taksapaguesit gjerman është e pamundur të argumentohet, se si për një asistencë të dhënë, në kundërshtim me marrëveshjet kontraktuale, kërkohet që të paguhen edhe taksa doganore, tatime apo tarifa të tjera. Po kështu, përpjekjet për t'ua kaluar detyrimin e këtyre pagesave partnerëve shqiptarë - në pjesën më të madhe struktura shtetërore apo komunale, si ministri, ndërmarrje ujësjellsash - nuk gjenerojnë të ardhura shtesë, por vetëm sa kalojnë financat nga njëri institucion shtetëror në tjetrin. Krahas kësaj është për ardhur të keq, që dy projekte në funksion të përmirësimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, me një rëndësi të madhe për popullsinë rurale të zonave përkatëse, për të cilat u ra parimisht dakord vetëm para pak kohësh, nuk mund të realizohen. Mosrealizimi i tyre argumentohet me nivelin e borxhit publik shqiptar. Në raste të tilla do të ishte e përligjur pyetja për vendosjen e prioriteteve."*

Dhoma Amerikane e Tregtisë ishte e para që ngriti zërin për problemet e gjobvënieve diskriminuese dhe mospagesën e TVSH, përmes një deklarate bërë në fund të vitit të kaluar për mediat.

*"...Po ndërmerret një fushatë e egër tatimore ku inspektorët janë duke zbatuar një interpretim të ri të ligjit duke vendosur gjoba të rënda edhe për aktivitete të viteve të kaluara që kanë qenë madje të kontrolluara nga tatimorët. Një sjellje jo profesionale e inspektorëve tatimorë, mandati i të cilëve duket se është vetëm mbledhja e gjobave edhe pse aktiviteti i biznesit është në përputhje me ligjin ekzistues.*

*Rimbursimi i TVSH-së po shkon shumë ngadalë. Afatet ligjore për rimbursim kanë kaluar dhe kjo ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë pengesa thelbësore në veprimtaritë e kompanive. Kjo gjë ndikon në kushtet financiare të kompanive dhe sidomos likuiditetet. Sipas ligjit ne fuqi, bizneset tashmë pretendojnë që rimburismi i TVSH-së duhet të përfshijë edhe interesat për periudhën që nuk iu është bërë rimbursimi.*

*Kontrolle të përsëritura dhe të pajustifikuara kanë vështirësuar jetën e biznesit. Kontrollet e mëparshme tatimore konsiderohen gabim nga inspektimet e tjera që vijnë më pas. Inspektorët ndryshojnë interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Ka inspektorë që vazhdojnë të kontrollojnë e rikontrollojne për të dhënat dhe veprimtarinë që nga viti 2006. E gjithë kjo situatë është shumë larg premtimit për të krijuar një klimë të qëndrueshme për biznesin dhe një atmosferë mikpritëse për investitorët dhe veçanërisht për investitorët e huaj.,, shkruhej në këtë komunikatë.*

Kur një vit pas ardhjes në pushtet, kryeministri Berisha shpalli nismën "Shqipëria 1 Euro", shumë u treguan skeptikë. "'Ne ta vazhdojmë përpjekjen tonë për të ndryshuar Shqipërinë në më të lirën dhe më të mirën për investorët e huaj dhe ata vendas. Do tu ofrohet toka me 1 euro, do tu ofrohet kualifikimi punëtorëve me 1 euro, uji teknologjik me 1 euro, shërbime të tjera të tëra me 1 euro, regjistrimi i biznesit me 1 euro, hyrja në Shqipëri me 1 euro.", tha kryeministri Berisha atëherë (BBC shqip shtator 2006)

Ide e bukur, po të ishte e ndershme. A operohet sot në Shqipëri me rregulla të qarta dhe të ndershme? Pushteti aktual "mban fjalën" vetëm për bizneset klienteliste që i shërbejnë direkt për mbajtjen e pushtetit apo që shihen si mundësi për manipulimin e opinionit publik shqiptar në prag të zgjedhjeve. Eshtë një situatë që duhet të na alarmojë seriozisht.

Shqipëria është kthyer në një vend ku "nuk lihen në baltë" vetëm ministrat e Gërdecit, apo 21 Janarit, ndërsa për këdo tjetër pasiguria është realitet kërcënues për ekzistencë.

## Haxhinasto takon ambasadoren e Republikës së Çekisë



**Zëvendëskryeministri dhe minister i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Edmond Haxhinasto takoi dje ambasadoren e Republikës së Çekisë, Bronislava Tomasova. Haxhinasto shprehu vlerësimin më pozitiv për marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë si dhe angazhimin e plotë për zhvillimin e mëtejshëm të tyre në fushën ekonomike. Ai theksoi se duhen ndarë qartë marrëdhëniet shumë të mira politike mes dy vendeve, me problematikën e një natyre comerciale, që shoqëria CEZ Shpërndarje ka në tregun e energjisë. Çdo thirrje për t'i përzier këto dy problematika është e dëmshme dhe nuk i shërben askujt - tha ai. Ministri shtoi se motivimi për privatizimin e sektorit të shpërndarjes nga një kompani çeke ka qenë i bazuar në dëshirën për të patur një performancë të lartë të standardeve evropiane.**

### Debati në “Facebook” midis një infermiereje të pushuar dhe Drejtorit të Politikave në MSh

# Akuza: Na latë 7 muaj pa lekë

### Foto e publikuar në “Facebook” nis diskutimin. Infermierja: Pse na pushuat nga puna dhe na latë pa rrogë? Pëllumb Pipero: Shfaqu pa maskë, eja për takim në ministri

*Lajmi*

**Një debat ka nisur në rrjetin social "Facebook", midis një personi të vetëquajtur "Infermierja Lsi" dhe Drejtorit të Politikave në Ministrinë e Shëndetësisë Pëllumb Pipero. "Infermierja Lsi" shkruan se infermierët e rinj kanë punuar në spital dhe nuk u janë dhënë rrogat për 7 muaj.**

TIRANE

JONIDA LATE

Debati midis “Infermieres Lsi” dhe Drejtori i Politikave në Ministrin e Shëndetësisë, Pëllumb Pipero, ka nisur pas publikimit të një foto në “Facebook” nga ana e infermieres.

**Infermierja Lsi:** Hani e shtroni dreka ju "kokat" e LSI-së, turp t'ju vijë. Ndërsa elektoratin tuaj të QSUT-së, infermierët e rinj i mashtruat e nuk i dhatë 7 muaj rroga,keni 2 vjet që talleni me kontrata mashtruese dhe nuk i kaloni definitiv. Normale se nuk ju ngelet buxhet, sepse i harxhoni me dreka dhe udhëtime dhe me mashtrime elektorale, por harroni se s'ka më budallenj sot. Ne po presim dhe disa ditë për të marrë vendimin tonë final, se nga cila anë do shkojmë në votime. Kjo varet nga ju sa të zgjuar jeni,sa real do jeni se ne infermierët e rinj nuk i kapërdijmë më gënjeshtrat tuaja, duam vepra, na bëni definitiv dhe hiqini kontratat mashtruese.

**Pëllumb Pipero:** Përshëndetje Znj/Zonjusha "Infermierja LSI", po ju shkruaj te komentet për foton, në të cilën jam dhe unë dhe që e përzgjidhni dhe e postoni ju në Facebook. Jeni me të drejtën tuaj të postoni një foto sikundër jemi dhe ne në të drejtën tonë edhe të ushqehemi edhe të ndajmë gëzime me miqtë. Unë jam person shumë i hapur dhe ju kam shpjeguar me qetësi se militantizmi, politik nuk ju bën gjithnjë të mundur një punësim afatgjatë, profesionalizmi dhe konkurrenca në tregun e punës jua mundëson këtë, madje pa pasur nevojën për suportin e partive, të cilat në demokraci ja lënë vendin njëra-tjetrës. Ndoshta je vajzë e re, ndoshta je në nevojë, e di që të duhet një vend pune, por nuk ke zgjedhur të konkurrosh, përkundrazi je fshehur pas emrit të një partie dhe vazhdon të bësh presion e shantazh, herë me vota, herë me foto e herë verbale, ç'ka nuk të nxjerr asnjëherë në rrugën e duhur. Shfaqu pa maskë, trokit për ballafaqim.



Fotoja e publikuar në “Facebook” ku është zhvilluar debati *(në rreth)* Pëllumb Pipero

**Infermierja Lsi:** Sa shpejt reagoni ju z.Pëllumb dhe sa shpejt reagojnë dhe servilët e partisë, sepse kanë frikë nga humbja se ju boshatisen xhepat. Ndërsa ne elektorati i thjeshtë luftojmë për bukën e gojës. Të gjithë ata që bërtasin e duan këtë parti veç për xhepat e tyre, ndërsa ata që bashkohen me problemin tonë e duan me zemër LSI-në, dhe të mirat e popullit tonë. Sa bukur reagojnë servilët, kur ju preket e ardhmja e karriges me te cilat mbushin xhepat, ndërsa për një problem madhor tonin që është njëkohësisht edhe i tyre dhe i shëndetësisë, se për popullin tonë as që duan t'ia dinë dhe kur vijnë në spitale pastaj kërkojnë shërbim të mirë, kushte të mira etj.

**Pëllumb Pipero:** Sinqerisht kisha vendosur të mos prononcohem, përgjigjem e shkruaj më në raport me një infermiere as profesioniste, as militante, por vetëm arrogante, me fare pak respekt ndaj vetes e profesionit dhe me aspak respekt ndaj të tjerëve, madje me një fjalor shpesh jo etik. Demokracia është mundësi gjithashtu dhe shteti nga ti jo-infermierja LSI dhe QSUT nuk është e vetmja mundësi për t'u punësuar, për më tepër përmes një apo disa votave që kurrë mos i marrtë asnjë parti nga ju dhe nga të tjerë që mendojnë si ju, pasi vota duhet të jetë bindje dhe jo interes. Vajzë a djalë qofsh konkurro, kërko si qytetare dhe jo si militante, mësohu të komunikosh dhe jo të hedhësh vrer. Ke gjetur vendin, kohën dhe njeriun e gabuar për të hedhur baltë, madje edhe për ta etiketuar me fjale që nuk dua ti kujtoj. Zoti të faltë, kaq e re dhe kaq arrogante dhe e pa sjellshme, madje e fshehur pas fytyrës të bamirëses me të madhe në botë. Ky është komenti i fundit për ju. Në ke fytyrë eja më tako në ministri.



Pëllumb Pipero

**Infermierja**

Direkt sa vura unë foton filluan të gjithë të komentojnë, të ofendojnë, të gjykojnë dhe të ankohen e disa të tjerë të mbrohen dhe tu shmangen përgjigjeve reale dhe si përfundim çfarë u bë? Asgjë!

**Infermjerja LSi:** Nëse jeni burrë z.Pellumb Pipero dhe ministri i shëndetësisë bashkë dhe me kryetarët e LSI-së, të dilni publikisht dhe mohojeni se ju keni qenë ata që na thoshit që të vazhdojmë punën se do të na rregullonit dhe ne punuam 7 muaj pa rroga që ju nuk na i dhatë kurrë ato lekë. Dilni dhe pranojeni publikisht se na keni mashtruar kur në korrik z.Vangjel Tavo, ka deklaruar se do të kalojnë me VKM 152. E pra, mos me thoni mua imorale apo gënjeshtare sepse gënjeshtarët e vërtetë jeni ju. Nuk i kam mohuar kurrë meritat tuaja sesi keni arritur aty lart. Ja ku po të them publikisht se unë jam elektorat i LSI-së dhe të vetmit që më pëlqejnë aty dhe i admiroj janë Z. Meta, Z. Ivziku, Z. Pipero, Znj. Kryemadhi. Të gjithë të tjerët janë veç servila. E pra nëse e shikoni mirë problemin që unë kam shtruar këtu nuk është thjesht një problem i imi por i shëndetësisë, sepse nuk bëhet shëndetësia me kontrata të dashur ministra, por me vendime të qëndrueshme.

### Elvana Hana

# Të rishikohet mënyra e financimit të spitaleve

*Në një takim të realizuar për autonominë e spitaleve,ISKSh, ka kërkuar rritjen e autonomisë së tyre*

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor kërkoi rritjen e shkallës së autonomisë për spitalet dhe ndryshimin e formës së menaxhimit të tyre, në mënyrë që t'i përshtaten ndryshimeve të parashikuara në ligjin e ri të sigurimeve shëndetësore. "Autonomia spitalore do të ishte hapi i parë i rëndësishëm drejt reformimit rrënjësor në drejtim të menaxhimit të financave, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të menaxhimit të shërbimeve të domosdoshme dhe ofrimit të tyre me kosto sa më të ulët", u shpreh drejtoresha e ISKSH, Elvana Hana, në tryezën




Takimi për autonominë spitalore

e rrumbullakët. Hana theksoi se situata aktuale e shërbimeve spitalore, si përdoruesit më të mëdhenj të shpenzimeve shëndetësore me 51% të shpenzimeve totale të skemës sonë duhet krijuar realizimi i nevojave e riorganizimi të këtij sektori. Sipas Hanës, dhënia e autonomisë duhet të shoqërohet me një program të qartë dhe me afate për implementimin e tij.

Ndërsa Ministri i Shëndetësisë Vangjel Tavo, i cili ishte i pranishëm në këtë takim u shpreh se rritja e cilësisë së shërbimit shëndetësor në spitale është objektiv i Ministrisë së Shëndetësisë, ndërkohë që përmirësimi i menaxhimit shikohet si një kusht për sukses. Ministri Tavo theksoi gjithashtu se duhet të vazhdojë procesi i pakthyeshëm i akreditimit të institucioneve spitalore, për të krijuar një mjedis e treg të hapur e konkurrent të shëndetit, në mënyrë që ndryshimet e realizuara dhe ato që janë në proces në spitale të lehtësojnë procesin e racionalizimit të rrjetit spitalor. E gjithë kjo, pasi do të kontraktohen ato spitale që punojnë vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë e kanë vlerësim të mirë të treguesve të performancës.

## Halimi dhe Cannon: Shërbimi i Provës është sukses

**Ministri i Drejtësisë Eduart halimi dhe dy ambasadorë, ai BE, Ettore Sequi dhe Ambasadori Britanik, Niçolas Cannon, kanë përshëndetur projektin e binjakëzimit të Shërbimit të Provës. Në fjalën e tij, Ministri Halimi, vlerësoi reformën e shërbimit të provës, si shumë të suksesshme. Sipas tij, ky shërbim i kursen buxhetit të shtetit rreth 30 milionë euro. "Kjo është një ndër reformat më të suksesshme që ndërmori Qeveria Shqiptare, përgjatë këtyre viteve të fundit në reformimin e drejtësisë penale. Me kryerjen e kësaj reforme, buxhetit të shtetit i janë kursyer rreth 30 milionë euro në vit. Statistikat tregojnë, se nga shërbimi i provës kanë përfituar rreth 4000 të dënuar, nga 8000 gjithsej". "Unë mendoj se disa nga iniciativat e fundit të Ministrisë së Drejtësisë, duke përfshirë krijimin e Shërbimit të Provës, janë interesante dhe të rëndësishme. Ato i shërbejnë publikut në mënyra konkrete prekin e individëve dhe kontribuojnë në procesin e integrimit evropian", u shpreh Cannon.**

### Sherri në lokal, Aglind Bejko qëlloi pas grushteve

# Djali i diplomatit plagos në Tiranë

*I riu, i biri i Ambasadorit shqiptar në Dubai*

*Lajmi*

**Djali i diplomatit plagos me armë në mes të Tiranës. Ngjarja e rëndë ka ndodhur dy netë më parë në një lokal, tek "Vasil Shanto". Policia njoftoi se Aglin Bejko, ka plagosur me pistoletë Martin Nonajn, pas një sherri banal. Bejko është djali i Behar Bejkos, Ambsadrori i Shqipërisë në Emiratet e Bashkuara Arabe.**

**TIRANE**

GRANIT SOKOLAJ

Ndoshta nga alkooli i tepër, apo nga kokëfortësia për të treguar veten, ka bërë që dy të rinj të përleshen fillimisht fizikisht e më pas kanë nxjerrë armët.

**KONFLIKTI**

Gjithçka mes Aglind Bejkos, 24 vjeç dhe bashkëpatriotit të tij (të dy janë me origjinë nga Fieri), Martin Nonaj, 25 vjeç, ka nosur në një lokal pranë shkollës "Vasil Shanto". Burime nga policia e Tiranës deklarojnë se, sherri ka nisur pas "kryqëzimit" të shikimeve të të dy të rinjëve, të cilët kanë vazhduar dhe më gjatë këtë "problem". Më pas, dë dy kanë filluar t'i bëjnë shenja njëri-tjetrit nga njëra tavolinë e lokalit në tjetrën, "pse më shikon", "njihemi gjë bashkë"? Dy të rinjtë, të cilët ndodheshin edhe në praninë e miqve respektivë, janë ngritur në këmbë e kanë debatuar, duke shkëmbyer dhe fjalë fyese, të cilat ka të ngjarë që Nonaj nuk i ka duruar. Dhe, siç mësohet nga burime të komisariatit numër 2, Nonaj e ka qëlluar me shuplakë Bejkon brenda ambienteve të lokalit. Të dy janë përleshur fizikisht, ndërkohë që shokët e tyre kanë tentuar ti ndajnë. Sapo kanë dalë jashtë ambienteve të lokalit, Aglind Bejko, sipas policisë, ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar drejt 25-vjeçarit, duke e plagosur rëndë. Kjo na ndodhur rreth orës 23.00, ndërkohë që menjëherë në vendin e ngjarjes kanë shkuart forcat e policisë. Ndërsa i plagosuri është nisur nga shokët e tij për në Spitalin Ushtarak, uniformat blu kanë nisur kërkimet për prangosjen e autorit, gjë që është bërë e mundur dje pasdite. Bejko është arrestuar, ndërsa i plagosuri, sipas policisë, ndodhet jashtë rrezikut për jetën.







**Në foto:** (*Majtas*) **Aglind Bejko, dalë pranë makinës së babait të tij Emiratet e Bashkuara** (*Lart*) **babai i tij Behar Bejko, Ambasadori i Shqipërisë në Emiratat e Bashkuara Arabe** (*Djathtas*) **i plagosuri Martin Nonaj**

**KUSH ËSHTË?**

Aglind Bejko nuk dihet me saktësi se prej sa ditësh qëndronte në Tiranë, pasi ai dhe familja e tij jetojnë në Emiratet e Bashkuara Arabe. Babai i Aglindit, Behar Bejko, është Ambasadori i Shqipërisë në Emiratat e Bashkuara Arabe.

Emri i Aglind Bejkos, duket se nuk është i panjohur për policinë dhe drejtësinë shqiptare. Në prill të vitit 2010, po në zonën e Vasil Shantos, dy grupe të rinjësh në kryeqytet, shkëmbyen zjarr ndaj njëri-tjetrit. Si rezultat, u plagos një vajzë me inicialet S.D, e cila ndodhej rastësisht në të njëjtin vend. sGrupet u ndaluar dhe arrestun, por dënimet ishin shumë të lehta për ta, nga 2 deri në 6 muaj burg. Dhe Aglin Bejko u dënua me 4 muaj burg, por pas vendimit doli shumë shpejt, duke llogaritur dhe kohën e paraburgimit.

## LAJME SHKURT

**Arrestohen tre duke vjedhur naftë**
Policia e kryeqytetit, ka bërë të mundur arrestimin e Arjan Ndreut, Arjan Gjana dhe Islam Gjana. Arrestimi i këtyre personave, është bërë rreth orës 00.15 të së mërkurës, pasi dyshohet se në vendin e quajtur Ibë, në një kantier ndërtimi, në rrugën Tiranë-Elbasan kanë vjedhur rreth 65 litra naftë. Kapet i kërkuari për drogëNjë i kërkuar është arrestuar nga policia e Tiranës. Eduart Remzi Salku, 36-vjeç lindur dhe banues në Tiranë, ka rënë në prangat e policisë, pasi mbi të ekziston një vendim i gjykate, sipas të cilit, Salku rezulton të jetë i dënuar me 3 vjet e 4 muaj burg. Ai akuzohet për vepërn penale të "prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike". Arrestimi i tij, u bë rreth orës 12.30 të së enjtes në rrugën Myslym Keta.

**Dy në pranga për cigare pa pullë**
Seksioni Kundër Krimit Ekonomik, ka bërë të mundur arrestimin në flagrancë të Gentian Reckës dhe Hasim Reckës. Arrestimi i këtyre personave, është bërë sepse gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin e tyre, u gjet një stekë cigare pa pullë fiskale. Më pas, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tyre, u sekuestruan dhe 85 steka të llojeve të ndryshme të cigareve pa pullë fiskale.

**Në pranga, vodhi PS në universitet**
Vodhi 4 kopjutera dhe 2 bateri, arrestohet. Ngjarja ka ndodhur në Universitetin Politeknik të Tiranës. Më datë 12.3.2008, Ardit Çala 26-vjeç ka hyrë në ambjentet e Universitetit Politeknik dhe ka vjedhur në zyrën e laboratorit të Inxhinierisë Mekanike, 4 njësi qëndrore dhe 2 bateri. Çala është një person me preçedent penalë, pasi më parë është dënuar për vepërn penale të " prodhimit dhe armëmbajtjes pa leje".

**Proçedim për 3 të mitur, vidhnin soba**
Policia ka filluar proçedimin penal për 3 persona të mitur. Ata janë A.Kodra 16-vjeç, M.Hidri 17-vjeç dhe N.Bulku 16-vjeç, të tre lindur dhe banues në fshatin Ibë. Të tre akuzohen, për vjedhje në bashkëpunim, pasi dyshohen se kanë vjedhur disa soba, 3 prej të cilave u sekuestruan.

### Vrasja

# Homazhet për Skurën, Rama: E tradhëtuan

*Krerët e shtetit dhe policisë marrin pjesë në ceremoni. Berisha: Nisma ligjore për policinë*

**TIRANE**

Trupi i pajetë i Shefit të krimeve të Burrelit Musa Skura u pre dje në varrezat e Dëshmorëve të Kombit, pranë kolegut të tij komisar Adem Tahiraj. Të dy gjetën vdekjen në krye të detyrës në luftën kundër krimit. Shokët i dhanë lamturimën e fundit duke shtënë në ajër 3 herë me breshëri automatiku, në shenjë respekti dhe përulje për detyrën e tij ndërsa familjarët hodhën lule dhe derdhën lot. Zyrtarë të lartë të shtetit, miq e familjarë i dhanë lamturimën komisarit, i cili u plagos rëndë gjatë një operacioni në krye të detyrës, gjatë një operacioni policor mbrëmjen e 13 janarit, në fshatin Suç, në zonën e quajtur Përroi i Keçit, në Mat dhe ndërroi jetë në spitalin e Foggias në Itali. "Komisar Skura është simbol i vlerave morale dhe njerëzore. Ky hero nuk rreshti 28 vjet duke punuar për të mbrojtur qytetarët e vendit të tij", tha Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj, në fjalën e lamtumirës në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. I vëllai i komisarit shprehu falenderimet për gjithë përpjekjet që u bënë për ta mbajtur në jetë. "Ishte e pamundur që Musai të jetonte. Trupi i Dëshmorit të Atdheut u përcoll drejt Varrezave të Dëshmorëve nga kortezhi i Policisë së Shtetit, ndërsa zyrtarë të lartë të shtetit, shok dhe miq të tij u përkulën para arkivolit të mbuluar me flamurin shqiptar, i cili ishte vendosur në Shtëpinë Qëndrore të Ushtrisë. Kryeministri Berisha u shpreh, se Skura ra në krye të detyrës duke luftuar me fallangat e krimit. Gjithashtu, kreu i ekzekutivit garantoi, se qeveria do të marrë hapat e nevojshëm ligjorë dhe mbështet forcat e policisë në luftën kundër krimit. Ndër politikanët që bënë homazhe, ishte edhe kreu i PS-së, Rama. "Jam këtu për t'i dhënë lamtumirën një tjetër komisari kurajoz. Janë dëshmorë në një luftë me krimin që ka fituar një epërsi të frikshme në kushtet kur fatkeqësisht policia është tradhtuar, braktisur dhe po rrënohet dita ditës nën një drejtim tërësisht të padenjë. Duke ngushëlluar këto familje, që i shtohen familjeve të dëshmorëve të betejës së stërzgjatur me krimin, dëshiroj që në nderim të këtij të angazhohem solemnisht, se dita e një përballjeje ku policia do të rimarrë terrenin e humbur dhe krimi do të zbrapset është shumë e afërt", tha Rama.

gr.so



Ceremonia e varrimit të Musa Skurës

## Konflikti i çastit, tenton të shtypë me makinë shokun

**Një tjetër sherr banal, është regjistruar mbrëmjen e së mërkurës në Tiranë. Dy të rinj, pas një konflikti të çastit kanë debatuar ashpër me njëri-tjetrin, aq sa kanë tentuar dhe vrasjen. Ngjarja ka ndodhur në lagjen nr.3, në Bathore. Klevis Spahiu, 23-vjeç banues në Bathore dhe Ardjen Daci 27-vjeç, kanë pasur një konflikt të çastit me njëri-tjetrin, konflikt i cili më pas ka degraduar deri në përplasje fizike. Pas debatit të ashpër, Klevis Spahiu, ka marrë automjetin e tij tip "Ford Escort" dhe ka tentuar të shtypë Ardjen Dacin. Pas tentativës, Spahiu është larguar menjëherë nga vendi i ngjarjes. Ndërsa Ardjen Daci, është dëmtuar rëndë në pjesë të ndryshme të trupit dhe është dërguar menjëherë në Spitalin Ushtarak për t'u mjekuar. Sipas mjekëve, ai është jashtë rrezikut për jetën, pasi plagët e marra janë të lehta. Seksioni kundër Krimeve ndaj Jetës, në komisariatin Nr.5 në Kamëz, ka bërë të mundur arrestimin e autorit Klevis Spahiu, për veprën penale të "tentativës së vrasjes". Gjithashtu në cilësinë e provës materiale, është sekuestruar dhe mjeti tip-Ford Escort me targa 282 KS 978. k.b**

### Shpallet në kërkim Aleksis Branko, Merja në spital

# Pacienti, karrige në kokë mjekut

## *Energjia në QSUT, revoltohet i sëmuri*

*Lajmi*

**Pacienti godet me karrige në kokë mjekun, duke i shkaktuar plagë të rënda. Incidenti ndodhi në pavionin e Urologjisë, pranë QSUT-së, kur Aleksis Branko, i cili kishte shkuar për një shërbim mjekësor, ka goditur ndihmës-mjekun Ruzhdi Merja. Ndërsa vetë është larguar duke u shpëtuar prangave.**

TIRANE

KLAJDI BODLLI

Mungesë energjie, luhatje tensioni... apo radhë. Këtë situatë, ka të ngjarë që një pacient në QSUT, i cili kishte shkuar aty që të bëjë një goditje gurësh në veshka. Por, pas dy ditësh që nuk ka mbaruar punë, ka goditur në hyrje të shkallëve me karrige në kokë, mjekun Ruzhdi Merja, 40 vjeç. Branko, prej dy ditësh ishte drejtuar në Spitalin "Nënë Tereza", për të kryer bombardimin e gurëve në veshka, pasi ndjente dhimbje dhe ilaçet e marra nuk bënin më efekt. Mungesa e energjisë elektrike, ka bërë të pamundur të mërkurën kryerjen e bombardimit. Ndërkaq të enjten, luhatjet e tensionit sërish nuk mundësonin kryerjen e tij, pasi paisja nuk mund të punonte. Shpjegimet e Merajt, i janë dukur shmangie e qëllimshme Brankos dhe në nerva e sipër, e ka goditur atë më karrige duke i shkaktuar plagë të rënda në kokë.

**NGJARJA**

Aleksis Branko 31-vjeç, nga Berati ka shkuar në Spitalin "Nënë Tereza", për të bombarduar gurët në veshka. Fillimisht 31-vjeçari, është paraqitur pranë pavionit të Urologjisë, ditën e mërkurë, ku dhe ka pasur kontaktin e parë me ndihmësmjekun Ruzhdi Merja. Merja i ka shpjeguar Brankos, se bombardimi ishte i pamundur për shkak të mungesës së energjisë elektrike dhe paisja nuk mund të punonte, duke i kërkuar të rikthehej ditën e enjte. Por dhe të enjten sipas Merja, nuk mund të kryhente ndërhyrjen pasi tensioni i energjisë elektrike, ishte i luhatshëm duke e bërë të pamundur vënien në punë të paisjes. Ky shpjegim i Merjas, ka sjellë acarimin e Aleksis Brankos. 30-vjeçari fillimisht ka debatuar me fjalë me Ruzhdi Merjan. Më pas, e ka goditur mdihmës mjekun e QSUT-së me karrige në kokë, duke e dëmtuar rëndë dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes. Menjëherë në vendngjarje, kanë ardhur forcat e Komisariatit nr.4, të cilët kanë marrë dëshmitë e personelit të spitalit, si dhe kanë identifikuar autorin. Ndërkaq Ruzhdi Merja, i është nënshtruar menjëherë kontrollove për situatën e tij shëndetësore. Ai është nënshtruar një skaneri në kokë, duke qenë se pas kokës ka marrë goditje të rënda dhe ka çarje, të cilat i kanë shkaktuar humbje të mëdha gjaku. Sipas kolegëve të tij, ai është jashtë rreziku për jetën, ndërkohë që Aleksis Branko, është shpallur në kërkim nga policia.

**SHKAKU**

Megjithë largimin e kompanisë CEZ, qytetarët shqiptarë dhe institucionet publike, nuk i kanë shpëtuar problemeve me energjine elektrike. Para disa ditësh, qeveria emëroi në krye të të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, administratorin e ri Said Dollapin. Pak ditë pas emërimit të Dollapit, si rrallë herë, mungesën e energjisë elektrike, e vuajtur dhe Qëndra Spitalore "Nënë Tereza". Të mërkurën, energjia elektrike ka munguar pothuajse gjith ditën në këtë institucion të shërbimit shëndetësor, duke paralizuar punën e të gjithë mjekëve. Ndërsa sallat e operacioneve, janë furnizuar nëpërmjet gjeneratorëve.

## Reagimet

### Drejtori i QSUT: Dhunuesi të vihet para drejtësisë

Menjëherë pas aktit të shëmtuar të dhunimit të një prej punojësve të bluzave të bardha, ka reaguar Drejtori i Qëndrës Spitalore "Nënë Tereza", Edmond Rrushi. Ai ka dënuar aktin dhe e ka cilësuar atë, si shumë të rëndë, duke kërkuar nga forcat e policisë të gjejnë autorin dhe ta vënë atë para drejtësisë. Sipas Rrushit, shkak për bllokimin e punës është bërë mungesa e energjisë. "Sulmi ndaj infermierit Ruzhdi Merja, është një ngjarje shumë e rëndë, kush godet bluzat e bardha do të ndëshkohet. Gjëndja e ndihmës-mjekut është e mirë. Nga mungesa e energjisë janë pezulluar disa ndërhyrje kirurgjikale", u shpreh Rrushi. Aktin e ka dënuar dhe shefi i pavionit të Urologjisë, Mustafa Xhani. Sipas Xhanit, bluzat e bardha janë në shërbim të qytetarëve dhe nuk mund të dhunohen në këtë mënyrë. "Bluza e bardhë sot u lye me gjak", u shpreh Xhani.



Pamje nga QSUT

### DHUNA NDAJ MJEKEVE

- **23.02.2008, Fier** Një 34-vjeçar nga Fieri ka rrahur mjekun roje Leon Shpatara ku.
- **12.04.2008, Tiranë** Një i sëmurë mendor qëllon me thikë shefin e kardiologjisë Ali Refatllari
- **09.10.2008, Tiranë** I riu godet mjekun roje në QSUT-së, Ibrahim Bruka, ish-deputet i PD-së.
- **24.10.2008, Tiranë** Rrihet në ambientet e Spitalit Ushtarak shefi i urgjencës, Myftar Torba.
- **11.07.2009, Tiranë** Rrihet në mes të pavijonit një mjek i spitalit të fëmijëve.
- **05.12.2010, Tiranë** Në QSUT, është dhunuar me grushta e shkelma kardiokirurgu, Edvin Prifti.
- **14.07.2011, Durrës** Mjeku i urgjencës, Lefter Salla është dhunuar nga tre persona.
- **05.04.2012, Vlorë** Shqetësimet për fëmijën, kanë bërë që dy persona të godasin me grushte mjekun pediatër.
- **03.09.2012, Korçë** Dhunohet me mjete të forta në sanatorium, Thoma Nini, ish-konsull në Selanik.

VLORE **Masa**

# Agresori i gjyqtares: Jam penduar

TIRANE

Ka kërkuar mëshirë para drejtësisë, për të mos e dënuar shumë, duke shprehur dhe pendesën e tij. I arrestuari 3 ditë më parë, si i akuzuar për sulmin me acid sanitar ndaj gjykatëses Mirela Mishgjoni, ka dalë dje para togave të zeza në Gjykatën e Vlorës, ndaj të cilit është dhënë dhe masa e sigurisë. Neritan Zotaj u la në burg pa afat, megjithë shprehjen e pndesës nga ana e tij. Kështu, ai do të qëndrojë në burg deri në përfundim të hetimeve, vendim ky i marrë nga gjykatësit e çështjes. Ndërkohë, në sa sallën e gjyqit, i arrestuari Zotaj, ka pranuar fajësinë e tij, duke dhënë dhe detaje të tjera të sulmit ndaj gjyqtares Mishgjoni, e cila u sulmua prej tij nëntë ditë më parë, teksa po dilte nga shtëpia. Gjatë rrëfimit të tij para trupit gjykues, i pandehuri Zotaj ka kërkuar mëshirë prej tyre, duke shprehur edhe pendim per aktin e kryer. Ndërsa burime nga personat që ndodheshin në sallën e gjyqit, saktësuan, se nuk ka paraqitur asnjë pretendim. Në të njëjtën linjë me të, ka qenë edhe avokati tij mbrotjes.


Gjyqtarja Mirela Mishgjoni

Zotaj u arrestua tri ditë më parë, pas disa ditësh hetime të policisë së Vlorës. I riu u ndlaua pas ditë më parë ka sulmuar me acid në fytyrë gjykatësen Mirela Mishgjoni, e cila siç është bërë e ditur, e kishte dënuar me 11 muaj burg për vjedhjen e një popmpe uji. k.th

## Ura me me shkallë rrezikon jetët e dhjetra banorëve

Ura me shkallë, siç e njohin banorët, pothuajse të shkatërruar. Përmes saj, lidhen disa lagje të qytetit të Fierit dhe kalojnë çdo ditë qindra qytetarë, mes tyre edhe fëmijë shkolle. Nga banorët njihet si "Ura me Shkallë", por pjesët anësore të saj janë degraduar tërësisht, jo vetëm si pasojë e mungesës së rikonstruksionit, por edhe nga dalja e lumit Gjanica gjatë ditëve të fundit nga reshjet e shiut. Banorët ndihen të rrezikuar, teksa kalojnë në këtë urë, pasi sipas tyre ajo është dëmtuar tërësisht ndër vite. Ata shprehen përballë kamerës së televizionit A1Report se "këtu kalojnë jo vetëm qytetarë të lagjesk por edhe fshatrat. Kanë hedhur urën dhe e kanë prishur. Kanë frikë të kalojnë nxënësit, se mos bien. Jo vetëm fëmijët, por edhe pleqtë. Kjo ka një rrezikshmëri për tërë dyqanet dhe qytetarët, që punojnë këtu sepse mund të përmbytet. Kjo përbën rrezik për banorët sepse e kemi parë vetë që njerëzit janë mbytur". Kjo urë e ngritur në vitin 1935 lidh lagjen "1 Maji" me Sheqin e vogël dhe lidh rreth 10 mijë banorë të zonës.

DURRES

### 18-vjeçares tre muajshe shtatzënë, iu pre koka

# Burg përjetë për vrasësin e vajzës

## Prokuroria kërkon maksimumin për Norjan

**Lajmi**

**Masakruesi i vajzës 18-vjeçare në Durrës, duket se do të qëndrojë në burg përjetë. Të paktën këtë ka kërkuar dje Prokuroria e Durrësit, e cila në pretencën e lexuar nga përfaqësuesi i akuzës. Sipas kërkesës, Shaban Norja, 18 vjeç, vrasësi i Ajshe Vatës duhet të dënohet me burg përjetë.**

DURRËS

ARTUR KORRIKU

Me antiplumb në kafazin prej hekuri, ka pritur i qetë konkluzionet e prokurorisë dhe pretencën. Dje nuk ka folur, por këtë duket se ia ka lënë në dorë avokatit. Shaban Norja, sipas prokurorisë së Durrësit, është autori i vrasjes dhe prerjes së kokës së vajzës 18-vjeçare, Ajshe Vata, e cila ndodhej dhe në muajin e tretë të shtatzanisë. Vajza me origjinë nga Kukësi, u ekzekutua mbrëmjen e 11 tetorit 2012 dhe më pas Norja i preu kokën për të vështirësuar identifikimin e viktimës. Ndërsa vetë, ai u arrestua pak ditë më vonë, pas një hetimi intensive të prokurorisë dhe policisë së Durrësit.

Në seancën e djeshme në Gjykatën e Durrësit, avokati mbrojtës i të moshuarit kërkoi që vendimi të merret sa më shpejt, ndërkohë që seancën e kaluar, ai kërkoi gjykim të shkurtuar, pasi klienti i tij pranoi akuzën.

Vrasja e Ajshes tronditi mbarë publikun. Trupi i saj pa kokë, u gjet 500 metra larg banesës së saj, në Xhafzotaj të Durrësit, ndërkohë që 80-vjeçari u arrestua një ditë më pas. Ai pranoi krimin dhe deklaroi se e kishte kryer pasi 18-vjeçarja nuk pranoi të abortonte fëmijën që kishte në bark. I moshuari pranoi se kishte pasur lidhje intime prej dy vitesh me vajzën e re dhe se fëmija ishte i tij.


Shaban Norja në gjykatë


Viktima Ajshe Vata

Pak ditë pasi u gjet trupi, u zbulua dhe vendndodhja e kokës së vajzës, e cila ishte fshehur në një ferrë pranë vendit të ngjarjes. Nga këqyrja e kësaj pjese të trupit të viktimës rezultoi se autori fillimisht e kishte qëlluar me armë zjarri pikërisht në kokë 18-vjeçaren dhe më pas me një mjet prerës ia kishte shkëputur kokën nga trupi. Sipas policisë, paraprakisht mendohet se bëhet fjalë për një krim pasioni.

Nga kontrolli i ushtruar në shtëpinë e 80-vjeçarit Shaban Norja, i cili rezulton person me precendentë të mëparshëm penalë pasi ishte dënuar me 9 vite burg për tentativë vrasjeje, është gjetur edhe arma e krimit si dhe prova të tjera materiale, si gjak në rrobat e tij që dyshohet të jetë i 18-vjeçares të masakruar disa ditë më parë në Xhafzotaj të Durrësit, e cila u gjet pa kokë disa metra larg banesës së saj, ndërkohë policia dyshon edhe për bashkëpunëtorë të tjerë të 80 vjeçarit në kryerjen e krimit.

Nga ekspertiza mjekoligjore rezultoi se 18-vjeçarja ishte 11 javëshe shtatzënë, ndërsa dyshimet e para për një incest brenda familjes u hodhën poshtë nga disa analiza të kryera në laborator.

Pas arrestimit, Norja pranoi autorësinë, si dhe atësinë e fëmijës, të cilin vajza e kishte në bark. Më tej, ai ka thënë se, Vata i ishte lutur që ta vriste, për të mbuluar turpin pas mbetjes shtatzënë. Gjyqi ndaj Shaban Nosjes nuk ka zgjatur më shumë se 3 muaj, pasi gjithçka ishte e qartë për prokurorët dhe hetuesit. Ata kishin provat e mundshme për ta lënë Nosjen në burg, ndërkohë që edhe autori pranoi ekzekutimin makabër.

FIER

### Masa

# Vrasësi i studentit mbetet në burg

Gjykata e Fierit ka lënë në burg Gentjan Shahinaj, si autori i dyshuar për vrasjen e 21-vjeçarit Andi Prifti. Prokuroria ka kërkuar masën e sigurisë "arrest me burg" për 25-vjeçarin, ndërsa avokati i Shahinajt i ka kërkuar gjykatës një masë më të lehtësuar, pasi sipas tij, autori nuk përbën rrezik për t'u larguar, si dhe s'ka prova të mjaftueshme për akuzën e krimit. Megjithatë, gjykata ka lënë në fuqi kërkesën e Prokurorisë, duke lënë 25-vjeçarin në kushtet e "arrestit me burg". Gentjan Shahinaj u arrestua nga policia dy ditë më parë nën akuzën e vrasjes me paramendim të Andi Priftit, më 20 janar të këtij viti në vendin e quajtur "Kulla e Ujit" në periferi të Fierit.


Gentjan Shahinaj

Prindrit e të arrestuarit, thanë dy ditë më parë për A1 Report dhe Shqiptarja.com, se djali i tyre, natën e vrasjes ka qenë në shtëpi në në orën 21.30, ndërsa ekzekutimi i të riut, ka ndodhur pas orës 23.00. Prifti u vra pasi fitoi në një local llotarish sportive një shumë prej 60 mijë lekësh. Sipas policisë, ai është vrarë për t'u grabitur, ndërsa dyshimet ranë mbi shokun e tij, me të cilin, sipas policisë së Fierit, është larguar me të njëjtin motor.

### LAJME SHKURT

**Shijak, arrestohet i dënuari për drogë**

Komisariati i Policisë së Shijakut, ka arrestuar për llogari të Policisë së Tiranës, Napoleon Çipin me banim në Shijak. Arrestimi i tij, është bërë pasi ka një vendim të Gjykatës së Tiranës, e cila e ka dënuar me 2 vjet e 9 muaj burg, për veprën penale të " Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike".

**Durrës, kapet për vjedhje kablli**

Policia e Durrësit ka arrestuar në flagrancë Orges Monen 24-vjeç me banim në Durrës. Arrestimi i tij, është bërë rreth orës 12.30 në lagjen 1 në Durrës, pasi ishte duke vjedhur një kabëll në një kabine elektrike. Mone, shoqërohej dhe nga një person tjetër i cili, në momentin që policia ka mbërritur në vendngjarje është larguar. Policia po punon për identifikin e tij.

**Vlorë, punonte si roje, vjedh pronarin**

Strukturat e Hetimit të Krimit në Komisariatin e Vlorës, kanë arrestuar Esheref Lazaj, 59-vjeç me banim në Vlorë. Lazaj punonte si roje i një subjekti tregtar. Ai është arrestuar për veprën penale të "vjedhjes" pasi dyshohet të jetë autor i vjedhjes së disa materialeve në subjektin tregtar, ku ishte i punësuar.

**Pogradec, vajza denoncon tutorin**

Mesnatën e së enjtes rreth orës 03:40, u bë ndalimi i shtetasit Erjon Çobani 40 vjeç, banues në lagjen 2 Pogradec. Arrestimi i Çobanit, është bërë pas kallëzimit të shtetases me iniciale D.R 17 vjeçe,banuese në Pogradec, e cila ka deklaruar se për një periudhë kohe rreth një muaji, 40-vjeçari e ka shfrytëzuar për prostitucion. Çobani, akuzohet për veprën penale "shfrytëzim i protitucionit në rrethana rënduese me të mitur".

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE

NJOFTIM REZULTATI KONKURRIMI

Gjykata Kushtetuese njofton se

**Zj.Diana Zebi**

është fitues në konkurimin për vendin e punës në pozicioni **"Përgjegjës e nivelit të lartë të zyres së Protokoll –Arshivë – Magazinës"** në Drejtorinë Gjygjësore dhe të dokumentacionit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE

NJOFTIM REZULTATI KONKURRIMI

Gjykata Kushtetuese njofton se

**Z.Kujtim PRIFTI**

është fitues në konkurimin për vendin e punës në pozicionin **"Specialist I nivelit të lartë I ruajtjes e sigurisë së brendshme"** në sektorin e Shërbimeve.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE

NJOFTIM REZULTATI KONKURRIMI

Gjykata Kushtetuese njofton se

**Znj.Thomaida XHOXHAJ**

është fituese në konkurimin për vendin e punës në pozicionin **"specialiste e nivelit të lartë-përkthyese"** në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë

# Aksident në Librazhd, dy të vdekur e një i plagosur

**Një aksident tragjik ka ndodhur në aksin nacional Elbasan-Librazhd, në hyrje të qytetit të Librazhdit, afër kryqëzimit kryesor të tij. Një kamion me targa të Maqedonisë, është përplasur me një makinë të sigurisë së një banke, e cila udhëtonte drejt Korçës. Si pasojë, nga përplasja e fortë, kanë mbetur të vdekur Ilir Velia, 35 vjeç dhe Trëndafil Bregasi, 41 vjeç, nga Skrapari. Ndëersa personi I tretë që ndodhej në makinë me ta, Xhevahir Kurti është plagur rëndë e pas ndihmës në Librazhd, është dërguar për në Spitalin Ushrarak në Tiranë dhe gjendja e tij ishte kritike. Ndërkohë, Peco Stojanovski, drejtuesi i kamionit me targa BT 582 FC, është shoqëruar në Drejtorinë e POlicisë së Elbasanit, për të sqaruar rrethanat e aksidentit tragjik. Paraprakisht, ekspertët e policisë rrugore nuk kanë dhënë një shkak shkak zyrtar për këtë aksidentit, por mendohet se është lagështira në rrugë dhe manovrimi i kamionit maqedonas, që kanë shkakruar 2 të vdekur dhe një të plagosur. Kamionët e shtetit fqinj, janë bërë disa herë shkaktarë për aksidente të ndryshme në rrugën Qafë Thanë-Durrës.** an.qo

SHKODER — U zbulua nga radarët, zhduken trafikantët

# Supergomone dhe 1.3 tonë hashash në Bunë

## Policia gjen drogën pak para nisjes në Itali

*Lajmi*

**Plot 1.3 tonë hashash është bllokuar në Velipojë, të rrethit Shkodër, teksa bëhej gati të ngarkohej me një gomone, për t'u nisur më pas drejt ujërave ndërkombëtare e ndoshta më pas drejt Italisë. Policia ka bllokuar lëndën narkotike, si dhe gomonen që kishte ardhur për ta transportuar.**

SHKODËR

Elvis Nabolli

Kur vëmendja është më shumë e përqëndruar te gomonet e tragjikut në Jug të vendit, apo edhe në zona të ndryshme të Shqipërisë së mesme, një rast shfaqet në qytetin e Shkodër. E pikërisht në lumin që shumë dekada më parë shërbente për të kaluar anijet tregëtare që bënin biznes me Shkodrën.

Kështu, policia e Shkodrës, zbuloi dje plot 1.3 tonë kanabis sativa, të paketuar më së miri, e afruar në bregun e detit, ku dhe një gomone kishte mbërritur për ta marrë. Efektivët e policisë kanë bërë të mundur sekuestrimin e lëndës narkotike pranë rezervatit të gjuetisë, në fshatin Pulaj, në plazhin e Velipojës dhe sëbashku me të, policia ka sekuestruar edhe një gomone me gjatësi 15 metër të gjatë, me 2 motorr me nga 600 kuaj fuqi secili. Rreth orës 7 të mengjesit të ditës së enjte, radarët e policisë kufitare kanë identifikuar një mjet lundrues të fuqishëm, i cili është futur në derdhje të Bunës për të vijuar më pas drejt lumit Buna ku edhe është ndaluar në breg te rezervatit. Ndërkohë, policia kufitare në rrugë operative, që mesnaten e kaluar, ka patur informacion për lëvizje të dyshimta dhe një dërgesë droge, por pa ditur saktësisht vendin. Me të konstatuar këtë lëvizje të çuditshme, policia është vënë në ndjekje nga uji, por edhe nga toka. Sipas burimeve zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Shkodrës, bënë të ditur se, efektivat janë vënë në ndjekje të komones, ndërkohë që dy përsonat që ndodheshin brenda mjetit lundrues, e kanë lënë këtë të fundit në breg të Bunës dhe janë larguar menjehëre, duke shfrytëzuar edhe bimësinë e dendur të rezervatit. Ndërkaq, pasi janë ndalur në breg të lumit, efektivët e policisë, afro 20 metër larg skafit, kanë zbuluar lëndën narkotike, e cila priste të ngarkohej brenda e të nisej. Në vendngjarje kanë mbërritur forca të shumta policie kufitare, si dhe Forcat Ndërhyrjes së Shpejtë, të cilat kanë nisur krehjen e zonës për kapjen e rrjetit të trafikantëve që dyshohet se kanë qënë disa persona. Sipas policisë, dyshohet se lënda narkotike është futur në rezervat nëpërmjet një automjeti të tonazhit të lartë gjatë natës, i cili ka shkarkuar në breg të Bunës. Nga ana tjetër, përsona të tjerë kanë qënë në pritje të ngarkimit të drogës për në gomone. Sipas policisë, destinacioni i lëndës narkotike ka qënë Italia, pasi duke u nisur nga fuqia e motorreve të gomones llogaritej, që në harkun kohor të 3 orëve, lënda narkotike të mbërrinte në destinacion. Por, zbulimi i lëndës narkotike ka bërë që trafikimi i drogës të dështojë. Policia ka nisur veprimet hetimore, duke marrë në pyetje dhe punonjësit e shërbimit pyjor për lëvizjet brenda rezervatit të mjetëve të dyshuara. Kjo është sasia më e madhe e drogës e sekuestruar në qarkun e Shkodrës, ku vlera e saj, nëse do të shkonte në destinacion konvertohej në disa qindra mijëra euro.

Pak ditë më parë, në Otranto, Guardia di Financa sekuestroi 381 kilogramë lëndë narkotike, e tipit marijuanë. Policia, gjatë një patrullimi, ka vërejtur lëvizjen e një mjeti të dyshimtë në ujërat territoriale italiane, duke u vendosur menjëherë në lëvizje për ndalimin e tij. Pas ndjekjes nga forcat e Guardia di Finanza-s, trafikantët braktisën në breg të detit gomonen 6 metra të gjatë duke u larguar në drejtim të paditur me ndihmën edhe të errësirës.



Droga e sekuestruar në Shkodër

**Radarët**

Mjeti lundrues, është zbuluar nga radarët, gjë që ka vënë në lëvizje policinë. Kufitarët e Velipojës, kanë vënë re në monitorët e tyre një mjet lundrues, i cili i afrohej grykëderdhjes së Bunës, gjë që në bashkërendim dhe me komisariatin e Shkodrës, bënë të mundur zbulimin e drogës.



Gomonia ku do të ngarkohej droga

## LAJME SHKURT

**Pranga italianit, bleu 15 kg marijuanë**

Një ri nga Lenola e Italisë, është arrestuar pasi kishte blerë 15 kilogramë mariuanë në Shqipëri dhe do ta dërgonte mallin në Itali. 25-vjeçari shkoi në ballkan për të blerë drogë, por udhëtimi i tij zgjati shumë pak. Aktualisht i riu, është i burgosur në Shqipëri dhe nuk dihet nëse do të proçedohet penalisht në Itali apo në Shqipëri. Policia po heton nëse i riu punonte vetëm apo ishte thjesht një korrier.

**Durrës, kapet vajza dhe tutori**

Dy persona janë ndaluar ditën e djeshme nga policia e Durrësit, spër shfrytëzim e ushtrim prostitucioni në hotele të zonës së Plazhit. Sipas njoftimit zyrtar, është arrestuar Andoil Periku, 21 vjeç nga qyteti i Durrësit, pasi shtetasi në fjalë dyshohet se përgjatë një periudhe 1 mujore ka shfrytezuar për prostitucionin ne lagjen Nr.13, zona e Plazhit, shtetasen V.D., duke i siguruar asaj klientelë. Po ashtu, në pranga ka përfunduar edhe 22-vjeçarja e cila "punonte" kundrejt shumave 4000 deri në 5000 lekë.

**Kruje, dy në pranga për vjedhje**

Policia e Krujës ka arrestuar dy persona dhe ka shpallur në kërkim një tjetër, për akuzën e vjedhjes. Sipas Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës, në pranga kanë përfunduar Jonild Muça, 26 vjeç, banues në fshatin Kodër-Thumanë dhe Mariglen Devën, 19 vjeç, banues në Fushë-Krujë. Dy shtetasit në fjalë dyshohet se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, si dhe me shtetasin Ernest Rama, 25 vjeç, i shpallur në kërkim, kanë vjedhur me thyerje shkollën 2-vjeçare profesionale në fshatin Hasan të Krujës.

**Vlorë, zbulohen hajduti minoren**

Komisariati i policisë së Vlorës, njoftoi dje se, u bë ndalimi për Vjedhje, 15-vjeçarit Xh.I. lindur e banues në fshatin Babicë e Vogël. I arrestuari për vjedhje, sipas policisë, dyshohet se ka qenë autor i grabitjes së një banesë në fshatin e tij.

ITALI — Trafiku

# Arrestohen për drogë tre shqiptarë

TERMO

Policia italiane e Teramos ka arrestuar bandën e narkotrafikut, e cila në dy vjet kishte qarkulluar një sasi prej 14 kg heroinë me një vlerë tregu prej 1.2 milion euro. Droga shpërndahej në disa qytete të Italisë, ndërsa banda përbëhej nga 3 shqiptarë dhe 10 italianë. Hetimet për bandën e narkotrafikut nisën në gusht të 2011, kur u ndalua një nga anëtarët e bandës, italiani Lorenzo Pinciotti, i cili pas masës "arrest shtëpie" është mbajtur në survejmin dhe përgjim, hetime këto që çuan policinë në identifikimin dhe zbardhjen e të gjithë anëtarëve të bandës.



Pjesë e hetimeve për bandën kanë qenë përgjimet telefonike, biletat e udhëtimeve, si dhe transfertat e parave të bëra ndërmjet anëtarëve të bandës. Ndër shqiptarët e arrestuar, janë Artan Kurti, 35 vjeç, me leje qëndrimi në Modena, Martin Troka, 24 vjeç, i cili banonte në Rexhio Emilia dhe Edmond Buzi, 30 vjeç banues në Acoli.

Banda kishte kohë që mbahej nën vëzhgim. Policia italiane, prej shumë muajsh, ndiqte lëvizjet dhe me një leje prokurori, ka mundur edhe të përgjojë shqiptarët e italianët në trafikun e tyre. Ndërkohë, pritet të nisë dhe procesi gjyqësor, gjë që mund t'i lërë në burg për shumë vite.

## Rrëfimi

**Këngëtarja e suksesshme Liljana Kondakçi vjen në një rrëfim të zakontë. Ktihimi në Tiranë preokupimi për bashkëshortin dhe mllefi me çka është thënë kundra saj. Italia dhe njerëzit më kanë vlerësuar shumë. Vetëm pak ditë më parë media publikoi lajmin se gjithçka kishte përfunduar për të në drejtësinë italiane. Ajo do t'i kthehet këngës sërish në Shqipëri**



**Në foto:** *(në rreth)* Liljana Kondakçiu në një nga lokalet e Tiranës pranë Teatrit "Metrolop"

**KËNGËTARJA** *e akuzuar për transport droge do të fillojë një fushatë të gjerë mediatike në vend*

# Liljana Kondakçi: Thashethemet për mua? U kam lënë Zotin

### "Jam duke u kujdesur për bashkëshortin, e kam sëmurë. Unë me pesë shtëpi? Kjo është çudi e madhe

TIRANE

ANILA ÇULI

Shtëpia ku banon këngëtarja Liljana Kondakçi, është në katin e fundit të një pallati pranë sheshit "Piaza", në kryeqytet. Duket një shtëpi normale, jo ndonjë luks kushedi se çfarë dhe pothuajse as pipëtin njeri. Diku pas saj ndodhen ca rrugica që Liljana i ka përshkruar me një shpejtësi për mbërritur në një nga kafet e lagjes pranë qendrës së "Teatrit Metropol". Aty ka lënë takim me një nga kolegët e saj të vjetër Sulejman Dibra për të gjerbur një kafe pas një kohe kaq të gjatë. Në fakt kanë dy ditë që e kanë lënë takim-kafenë, por Lili (siç e thërrasin miqtë dhe të afërmit) me zor gjen kohën që t'u dedikohet, pikërisht atyre me të cilët kanë ndarë plot suksese dhe turne gjatë gjithë karrierrës së saj. Në fakt ne që jemi duke e pritur mezi e shohim pasi Liljana ka zgjedhur rrugicat për t'iu larguar syrit kureshtarë të njerëzve dhe padyshim mediave, lidhur me çka përflitet për të ditët e fundit. Në fakt Tirana zien, mediat janë bërë copa për të marrë qoftë një prononcim nga këngëtarja, ( intervistë as që bëhet fjalë, e le pastaj të dalë në kamera as që e diskuton një gjë të tillë në këto kushte, e pa krehur dhe e pa grimuar).

Liljana ka veshur një xhup pellushi leopardi dhe flokët i mban të kapura bisht. Është tejet e thjeshtë dhe e komunikueshme. Ndihet e qetë dhe në paqe me veten për çka

> **...i urren mjaft gazetarët në këto momente, flet me mllef për ta pasi sipas saj kanë shpikur mbi jetën e saj, kanë hedhur baltë, e kjo është një lloj "hakmarrje"**

është folur lidhur me të. Sytë I kanë mbetur të bukura dhe po ashtu dhe lëkura dhe zëri.

* * *

Në fakt i urren mjaft gazetarët në këto momente, flet me mllef për ta pasi sipas saj kanë shpikur mbi jetën e saj, kanë hedhur baltë, e kjo është një lloj "hakmarrje",e butë nga ajo tashmë.

"Kanë folur se unë paskërkam pesë shtëpi në Gjermani, Greqi apo ku di unë ku janë këto shtëpi? Pas kanë thënë, se paskërkam problem me Përmbarimin paradoksale e gjitha kjo??!, nëse do kisha kaq shtëpi. Po të ishin motrat e tyre dhe të afërmit e tyre sigurisht nuk do të flisnin kështu, nuk do të abuzonin kaq shumë, nuk do të hidhnin baltë apo jo?", më drejtohet mua të cilën më premton (je e vetmja që po pranoj të bisedoj, gazetarëve të tjerë nuk u kam hapur derën, madje je e vetmja që po bindem të të jap një intervistë më të gjatë në ditët në vazhdim)", shton.

"Nuk kam reaguar nuk dua të merrem as me gazetarët as me televizionet. Sa më shumë ata flasin aq më shumë lartësohem unë, e ke parë ti që unë s'kam folur fare? Lërua zotin mbi kokë", më drejtohet mua dhe mikut tonë të përbashkët teksa rrufisin kafenë e porositur. Askush nuk është kujtuar për mua më parë. Përse nuk kanë ardhë të më pyesin, të më marrin në intervistë?

"Liljan po ku keni qenë këto ditë?", e pyes unë.

"Këtu kam qenë, lërë ç'thonë këta erdhi dje, erdhi sot. Në shtëpi kam qenë , mbaj mbesën kam dhe bashkëshortin jo mirë nga gjendja shëndetësore këto kohë. Duhet të kujdesem për të. Po ashtu shkoj dhe nga mamaja ajo është e moshuar".

"Ju keni qenë në arrest shtëpie apo në burg", guxoj unë dhe e pyes. "Oh të lutem as mos t'a dëgjoj atë fjalë", më kthehet mua dhe më largohet së tepërmi.

"Drejtësia italiane bëri punën e saj, më në fund u pa kush ishte Liljana Kondakçi. Jam shumë e vlerësuar nga shteti Italian dhe italianët", flet për to e ndërsa duket se ka një respekt. Do të tregoj në një rrëfim tjetër më të gjatë më premton mua, që këmbëngulë aq shumë për ta realizuar sa më parë atë intervistë. Do ta lëmë të premten se do të jem e ftuar tek Çani atje do të këndoj një këngë dhe do të largohem. Nesër gjithë ditën jam e zënë", e më rrëfen me natyrshmëri edhe gjërat personale që kërkon të bëjë një ditë më vonë.

"Do të jem dhe tek emsioni i Rudinës, sepse ka shumë kohë që më është lutur dhe ka qenë e vetmja që do të të më prezantojë si një nga këngëatrete rralla që këndon në këtë moshë live".

Mediat italiane ju kanë krahasuar me Minën, shtoj unë.

"Po e vërtetë unë kam dhënë koncerte atje dhe ata më kanë vlerësuar për zërin dhe normalisht që e meritoj një vlerësim të tillë".

Ju ngjan një këngëtare e re i

> **"Këtu kam qenë, lërë ç'thonë këta erdhi dje, erdhi sot. Në shtëpi kam qenë , mbaj mbesën kam dhe bashkëshortin jo mirë nga gjendja shëndetësore këto kohë.**

them unë, një...

Eh po jo jemi larg, më shton dhe qesh.

Në fakt është 60 vjeç dhe më çudit pasioni që ka për këngën . Flet me shumë pasion me mikun e saj Dibra, për një klip të ri për kompozime dhe këngë të reja. Shkëmben numra artistësh dhe premton se së shpejti ka aktivitete dhe projekte lidhur me këngën.

## Viti 2006

## Drejtësia italiane e akuzoi për trafik droge

Liljana Kondakçi nisi problemet me drejtësinë italiane në verën e vitit 2006, kur u ndalua në stacionin hekurudhor të Sibarit, teksa transportonte 3.3 kilogramë kokainë në një pako. Në mediat italiane, thuhet se përdorej emrin i koduar "mamaja" dhe "këngëtarja", pasi kështu thirrej nga trafikantët, gjë e provuar dhe nga përgjimet e bandës. Ajo dyshohej se ishte pjesë e një rrjeti trafiku droge, të përbërë nga 20 anëtarë. Në atë kohë u lirua, pasi Kondakçi pretendonte se nuk e dinte çfarë kishte pakoja dhe ia kishin bërë dhuratë. Më vonë, drejtësia italiane e provoi se ajo ishte pjesë e grupit të trafikut, madje edhe me përgjime dhe e dënoi atë në mungesë me 2 vjet e 8 muaj burg. Ndërkohë që u shpall në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, policia greke e arrestoi këngëtaren në Selan-



ik, për ta ekstraduar më pas drejt Italisë. Këngëtarja e njohur Liliana Kondakçi, prej pak ditësh është liruar nga burgu në Itali, ku ka përfunduar dënimin me 2 vjet e 8 muaj burg, për akuzën e transportimit të drogës, ndërkohë që menjëherë është rikthyer në Shqipëri. "La Gazzeta del Sud" në Itali publikoi lajmin se këngëtarja shqiptare u lirua dhe u riatdhesua në Shqipëri. Ndërkohë, Kolegë të ngushtë të këngëtares konfirmuan për Shqiptarja.com dhe Tv A1 Report, se Kondakçi, gjatë gjithë këtyre muajve ka qenë në burg, pasi nuk kanë pasur asnjë kontakt me të.

LUGA E ARGJENDTE

# Antipastë me Panxhar të kuq dhe Topinambur

## Vlerat e Panxharit të kuq dhe cfarë është bima e njohur si argjinarja e Jeruzalemit

TIRANE

NGA DHURATA THANASI

Panxhari është i njohur si një pastrues gjaku dhe ndërtues i gjakut i cili ndihmon në krijimin e qelizave të kuqe. Lëngu i panxharit përmirëson strukturën e gjakut dhe shëron sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, të zorrëve dhe sistemit të tretjes. Lëngu i panxharit shkrin gurët në veshka, mëlçi dhe fshikëz. Tek panxharet janë gjetur edhe qeliza CD8 të cilat shërbejnë për shkatërrimin e qelizave kancerogjene. Kanceri i zorrës së trashë është lloji



i tretë më i diagnostikuar i kancerit ne SHBA dhe lloji i tretë kryesor i vdekjes nga kanceri. Shumë njerëz mund të përfitojnë duke pire një gotë lëng panxhari ne ditë. Pirja e lëngut të freskët të panxharitështe një masë parandaluese shëndetësore e mrekullueshme që mundtë ndihmojë në zgjidhjen e shumë problemeve.

**TOPINAMBUR, OSE ARGJINARJA E JERUZALEMIT**

Topinambur (Helianthus tuberosus)- apo patatja hebre- e quajtur dhe argjinarja e Jeruzalemit, është një bimë... ▶ vijon në faqe 17

VITI II NR: 3 E PREMTE, 25 JANAR 2013

SUPLEMENTI I SË PREMTES TE [SHQIPTARJA.com]

Fundjava

E-MAIL: FUNDJAVA@SHQIPTARJA.COM

INTERVISTA ME AKTOREN

RREFIMI PER BUKURITE E NATYRES DHE RELAKSIN SHPIRTEROR

# UDHETIMI, PARAJSA TJETER E MONIKA LUBONJES

## Adrenalinë dhe frymëzim mes shoqërisë dhe larg rutinës së jetës së përditshme

TIRANE

ROVENA RROZHANI

Kush e ka provuar atë ndjesinë e paqtë që të jep një udhëtim larg rrëmujës dhe miletit? Kush ka pritur me padurim fundjavën për tiu gëzuar bukurisë së natyrës dhe relaksit shpirtëror? Nuk besoj të ketë një njeri që të mos e shijojë të paktën një udhëtim në jetën e tij. Por nga ana tjetër ka nga ata njerëz që adhurojnë atë gjendje që sjell një udhëtim, dhe për cdo herë e përjetojnë si një aventurë si një adrenalinë dhe si një ëndërr që duhet të vazhdojë në kohë. Monika Lubonja, aktorja dhe producentja që nuk humbet asnjë shans që i jepet për të udhëtuar, është njëra syresh. Sapo gjendet përballë një kohe të lirë, sidomos pas një periudhe të gjatë pune, nuk ia përton të "nxisë" një grup udhëtimi... Ftesa mund të jetë edhe virtuale sic bëhet rëndom komunikimi shoqëror në rrjetet si facebook, por sapo grupi formohet, sapo miqtë mblidhen fillon aventura së... ▶ vijon në faqe 14



**Në foto:** Monika Lubonja me vajzen e saj, Tea

DESHIRONI TE UDHETONI



## "Shqiptarët, me sytë drejt natyrës

Ndonëse ngadalë, shqiptarët po i rikthehen nga pak natyrës, ose të paktën mes të rinjve po spikasin klube guidash që organizojnë udhëtime të shkurtëra në kohë. Janë udhëtime ku njerëz të panjohur mblidhen për të kaluar një ditë ose një fundjavë në një ecje në natyrë... ▶ Faqe 15

FILMI NE KINEMA



## "Les Miserables" vjen shkëlqimi i të mjerëve

Ndërsa është në pritje të verdiktit nga Bafta dhe Oskar për 17 nominimet në këto dy gara të rëndësishme kinematografike, "Les Miserables" fillon projeksionet shqiptare në kinema Millennium, prej datës 25 janar. Me kritika pozitive, arkëtime të... ▶ Faqe 16

## Njerëz në udhëtim

**FUNDJAVA** *ndryshe e aktores. Rrëfimi për bukuritë e natyrës dhe relaksin shpirtëror mes shoqërisë, gatimeve, ekskursioneve dhe adrenalinës larg jetës së përditshme*


**Në foto:** Aktorja Monika Lubonja

# Parajsa tjetër e Monika Lubonjës

## *Udhëtimi si sport i trurit dhe i mendjes*

TIRANE
ROVENA RROZHANI

*vijon nga faqja 13*

...bashku me atë gjendje që vetëm ata që e kanë provuar ia dinë vlerën. Dhe vetëm ata që ia dinë vlerën, dinë edhe ta rrëfejnë në rubrikën më të re të "Fundjava", "Njerëz në udhëtim".

**Para disa ditësh i bëre një ftesë virtuale miqve për të udhëtuar.. po bëheni gati për një fundjavë ndryshe?**

Në këto ditë të ftohta me shi dhe pak të mërzitshme...nuk e di pse por duke hedhur vështrimin përtej dritares...më doli nga mendja ky udhëtim i papritur e spontan. Ndoshta mërzia që të kap pas festave të fundvitit...ndoshta gjendja gri që ka pushtuar gjithçka...ndoshta njerëz që i shikon të stresuar...nuk e di po gjithmonë në këto situata vendos të kërkoj të dal diku për të harruar gjithçka që më rrethon. Një ftesë për miqtë e mi është dhe një dritare për ta kaluar bukur një fundjavë e pse jo dhe të hash ato gatime të shishme që ka ajo zone...eee pa më thuaj pak nuk do të kishit dëshirë të hanit një lakror korçar të bërë në saç...po pak turshi pe Korçe ...lëre pastaj oxhaku dhe drurët që kërcasin dhe ti që fillon e të kap një frymëzim i bukur ndoshta edhe për të bërë pak "thashetheme të bukura"...a për ndonjë ide që të kap në ato momente...që më pas i realizon falë atij pushimi dhe relaksi që ti ke marrë... E që t'i përgjigjem pyetjes ftesën e kam bërë për miqtë e mi e kësaj rradhe dua të jem në Dardhë.

**E formove grupin për këtë udhëtim të rradhës?**

Jam në pritje të të bërit grup...Një mikja ime më tha: "Po ne akoma nuk kemi tretur gjelin ti do të na frysh prapë?! (qesh).

Si kalon një ditë udhëtimi për ty apo me ty?

Të them të drejtën udhëtimet i kam pasur siklet kur isha e vogël dhe me sa më kujtohet edhe deri vonë. Por kur mësova makinën dhe udhëtoja me të dhe stomaku mu rregullua, nuk më zinte më. Dhe jo vetëm kaq, por u dashurova aq shumë me udhëtimet sa kisha dëshirë të isha shpesh me rrugë. Udhëtimi për mua është një emocion në një formë krejt ndryshe. Një adrenalinë e bukur që të përshkon që nga mendimi që ti do të nisesh e deri në detajet e fundit që ti përgatit për udhëtim. Unë kam udhëtuar shumë nga bregu gjatë shfaqjeve që kemi dhënë në turne. Nuk kam për të harruar Vlorën, udhëtimin me Yllka Mujon dhe Elian, Arditën që ishte menaxhere dhe Tean...Di vetëm që kemi qeshur dhe një zot e di si nuk kemi bërë ndonjë aksident...Një nga udhëtimet që nuk kam për ta harruar ishte Festivali i Butrintit...Ne ishim me shfaqjen "Elektra". Paraditeve shkonim në plazh. Atë ditë mora në makinë Yllka Mujon me Elian dhe vajzwn time, Tea me një shoqen e saj. Po shkonim në Ksamil për të bërë plazh. Tërë kohën bëja luftë me Tean dhe shoqen e saj... eh për idera të ndryshme. Kur në rrugë pashë një shokun tim. I rashë borisë,por ai nuk më pa. Pastaj e parakalova dhe gjithë kohës nuk i hapa rrugën ...sa ai bënte me sinjale, i binte borisë, por unë hiç.., Bëra garë në atë rrugë të ngushtë sa kur ktheva kokën pashë që asnjëra nuk bilbilonte si më parë. Pashë Yllkën ajo ishte futur në sedilje e nuk fliste fore..e vetmja fjalë që më tha ishte: "Aman se kemi vajzat..." Kam qesh me lot se unë po i jepja makinës e kisha marrë një adrenalinë të paparë.Vetëm kur ndaluam Yllka me tha:"O gocë më iku gjaku..." Pastaj atë ditë vazhdova me foto që i bëja Teas dhe të gjithëve me rradhë..

**Udhëtimi në grup apo vetëm, cili është më i pëlqyeri për ty? Cfarë shoqe udhëtimi je dhe çfarë tipash janë të përshtatshëm në udhëtime me ty?**

Sigurisht që të udhëtosh duhet të kesh dhe shoqërinë që ti pëlqen dhe të jenë një tip pak a shumë. Në përgjithësi dhe miket ose miqtë e mi i zgjedh që të kemi të përbashkët shpirtin, entuziazmin dhe pse jo rreziqet që mund të ketë dhe një udhëtim. Gjithmonë më kanë qëlluar miq që i pëlqejnë shumë udhëtimet, tipa të humorit, natyra të paqme që kur vijnë në një udhëtim i kanë harruar çdo gjë që kanë në shtëpitë e tyre...dhe përshtaten shumë bukur me grupin...

> **Miqtë**
>
> Gjithmonë më kanë qëlluar miq që i pëlqejnë shumë udhëtimet, tipa të humorit, natyra të paqme që kur vijnë në një udhëtim i kanë harruar çdo gjë që kanë në shtëpitë e tyre...dhe përshtaten shumë bukur me grupin...

**Një udhëtim i veçantë që ka zënë vend në kujtesën tënde?**

Mua më pëlqen shumë të udhëtoj me miqtë e mi se kuptohet në një grup të mirë dhe të bukur siç jemi ne vetë, bukur ia kalon. Një udhëtim që më ftuan e nuk kam për ta harruar ka qenë ftesa që më bëri Jona me Edën. Këtë udhëtim e organizoi mikja ime, Jona për në Voskopojë. Nuk kisha qenë më parë atje.Vetëm idea që do të isha me miqtë e mi më të mirë më bëri që të provoja Voskopojën. U nisa bashkë me Tean po të them të drejtën kur arrita në Voskopojë më kapi një ndjesi e çuditshme që as fjalën nuk e gjeja dot. Nata me bardhësinë e bashkuar më sillnin dhe frikën, dhe bukurinë e të qenurit midis këtyre gjërave dhe mendimeve të papritura që më vinin... Nuk flisja fare. Kur dëgjova Jonën që më thoshte:" Prit, prit se ka akoma"!Dhe sigurisht që kishte gjithçka. Ishte një shtëpi që e kishim pushtuar vetëm grupi ynë...dhe mendo që sa u ulëm e deri sa jemi ngritur nuk e kam kuptuar pse nuk e ndjeva lodhjen . Një mall të paparë pata kur ndieva gatimet e tyre të mrekullueshme...shije që i kisha harruar për shumë kohë. Shikoja ato vajzat që na shërbenin dhe më dukeshin sikur ishin pjestaret e grupit tonë... pastaj vera që, o Zot sa më ka shijuar (të them të drejtën nuk e pi ose e pi shumë shumë rrallë, por si atë natë dimri kurrë nuk më kishte shijuar) dhe mbi të gjitha ai oxhaku dhe ai zjarri bubulak... Sa më ngrohte ajo kërcitja e drunjve që më jepnin një melodi aq të bukur në vesh dhe era e tymit të drurit më kënaqte pa fund...Ah, di që atë ditë kam ngrënë sa për të gjithë bashkë...Vrapoja pak ose kërceja që të hapej një vend në stomak për të filluar prapë nga e para (qesh)

Të nesërmen ekskursioni që na kishin organizuar ishte adrenalinë e paparë për mua...Ecja e lumturohesha që shikoja atë pafundësi të madhe dëbore. U ktheva në një fëmi që doja ta shkelja pafund atë bardhësi dëbore ..ecja në dëborë më bënte shumë të lumtur e të çliruar aq shumë sa kur pashë një derë të zezë me kangjella mu duk sikur po më priste rrugën, mu duk sikur më prenë hovin..."Stop" më tha dera s' ke ku shkon më..Dhe unë që i them mikes sime:"Më mirë tani më lidh tek ajo derë se ndryshe nuk do të kem kthim...eh, udhëtimi i Voskopojës për shumë kohë më ka lënë shijen e një nga udhëtimeve më të bukura që kam bërë. Aty ishin të gjitha; shoqëria, vendet turistike shumë të bukura plot me bardhësinë e borës, gatimet, ekskursioni fotot në grup, të qeshurat pa fund...dhe në fund mora dhe trishtimin që ato ditë ikën sa hap e mbyll sytë...Një pjesë të ëndrrës e lashë aty për t'iu kthyer përsëri borës së bardhë, të paprishur që të vazhdoj aty ku e lashë ecjen e gjatë në dëborë....


**Në foto:** Monika Lubonja me miken e vogel Klea

**Thuhet se udhëtimi është një instrument edukimi, një ushqim shpirtëror, burim frymëzimi, përvojë jetese etj. Sipas teje çfarë është udhëtimi?**

Udhëtimi është sport i trurit dhe i mendjes, është çlirim, është rrëfim, është adrenalinë, është një moment i bukur që rri me miqtë e tu e ti i dëgjon e të dëgjojnë jashtë atyre halleve dhe streseve që kemi...Ti në udhëtim njeh dhe me shumë se ç'kërkon nga vetja. largohesh nga shtypja e përditshme që të bëjnë me biseda, nga shtypja e televizioneve që të enjtin kokën me politikë, me hipokrizinë që vënë në fytyrë kur dalin në ekran...i harron të gjitha. Ti shikon që miqtë e tu buzëqeshin bukur, ti shikon që këndojnë bukur, që mendojnë bukur dhe këtë ta jep vetëm udhëtimi dhe natyra që të çliron...Më lër tani se do të filloj romanin e parë dhe pak kohë ...do shkoj në Dardhë pranë oxhakut dhe në krah do të kem lakror të gatuar në saç dhe dhallë... Afër tyre do të rri duke përfunduar romanin që më nxite ti mikesha ime për ta shkruar...do shpërthej si shkrimtare. (qesh)

## Dëshironi të udhëtoni

**SI PO RINGJALLET** *tradita e ecjeve në natyrë dhe udhëtimeve në grup. Çfarë ndryshon nga ekskursionet e paraviteve 90*

# "Shqiptarët, rikthim në natyrë pa dallim moshe!"

## *Ismail Hoxha, drejtues i "Discover Albania"*

**TIRANE**

Ndonëse ngadalë, shqiptarët po i rikthehen nga pak natyrës, ose të paktën mes të rinjve po spikasin klube guidash që organizojnë udhëtime të shkurtëra në kohë. Janë udhëtime ku njerëz të panjohur mblidhen për të kaluar një ditë ose një fundjavë në një ecje në natyrë të kushtëzuar sipas stinës. Në vjeshtë nëse ndiqni guidën e klubit "Discover Albania" mund të eksplorohet e gjithë zona rreth Tiranës, duke shijuar të gjitha bukuritë e vjeshtës apo të pranverës. Në verë mund të udhëtohet drejt veriut ndërsa në stinën ku jemi dy itineraret më të preferuara të fundjavës mbeten Voskopoja dhe Dardha. Pavarësisht destinacionit, të gjitha shëtitjet apo ecjet në natyrë janë një aktivitet fizik që synon të largojë sidomos të rinjtë nga qëndrimi ulur në një kafe apo klub për orë të tëra. Janë një thirrje për të kaluar kohën e lirë në një formë më të shëndetshme, më të bukur, më shoqërore dhe më të pasur nga ana shpirtërore. Të paktën kjo është dëshira e Ismail Hoxhës që drejton Klubin e Kampistëve "Discover Albania" dhe për cdo javë bën thirrje të gjithë të rinjve të bashkohen në guidat e tij. Kontakti për të kaluar një fundjavë të bukur? Mjafton të kërkoni faqen e klubit në facebook.

**Udhëtimet në natyrë , si është raporti i shqiptare me këtë aktivitet para dhe pas viteve 90?**

Udhëtimet në natyrë, sigurisht që kanë ekzistuar para viteve 90, por atëherë pjesëmarrës më së shumti kanë qenë segmente të caktuara të shoqërisë siç ishin (Studentet kryesisht te Histori-Gjeografise, nxënësit dhe ndonjë grupmoshë tjetër), ndërsa ata që shëtisnin në mal kanë qenë të vetëorganizuar. Ne shpeshherë në klubin tonë kemi pjesemarrës që na tregojnë se si funksiononte atëherë. Mendoj që pas viteve 90 ka lindur më shumë nevoja për organizime të tilla, duke qenë se shoqëria po shkon me shumë drejt individualitetit, që do të thotë që mundësitë e organizimit në grup po bëhen gjithmonë e më të vogla (kjo sigurisht krahasuar me para viteve 90). Sot, është më ndryshe, është një shëtitje në natyrë, ku i rëndësishëm nuk është destinacioni, por rrugëtimi, ku herë pas here ndalemi dhe buzë një liqeni, fshati pa emër, për të shijuar këtë pamje. Sot, e duam më shumë natyrën sepse na mungon më shumë. Sot i duam më shumë aktivitetet se jemi bërë më pasivë. Sot e duam me shumë Shqipërinë se e njohim më shumë atë.



**Në foto:** Nje grup te rinjsh gjate nje ekskursioni me klubin "Discover Albania"

**Si i zgjidhni itineraret? Sa itinerare keni kryer deri tani dhe cili prej tyre ka qenë më i suksesshmi?**

Ne nuk kemi një listë fikse ose të mbyllur të itenerareve. Fillimisht kemi zgjedhur itenerare ku kemi qenë më parë me shoqërinë, duke ditur që janë vende mjaft interesante. Më vonë herë pas here kemi pasur sugjerime nga pjesëmarresit, duke na rekomanduar dhe ndarë me ne eksperiencën e tyre në vende që atyre u kanë lënë mbresa. Kjo ka bërë që lista jonë të jetë mjaft e larmishme dhe shumë e azhornuar. Është bukur kur ke propozime nga anëtarët për ndonjë vend të vecantë, ku ai/ajo për një arsye ose tjetër ka patur mundësi ta vizitojë dhe tani këtë eksperiencë të bukur e ndan me ne. Guidat tona janë të ndara në dy kategori kryesore. Të parat janë guidat e fundjavës. Deri tani kemi qenë të shtrirë në Veri ku ndër më kryesoret kanë qenë guidat në Theth, Valbonë, Kalimi Valbonë - Theth, Vermosh. Gjatë verës kemi qenë më shumë të fokusuar në jug, ku kampingjet e shumta duke filluar që nga Gjipea e deri në Himarë kanë qenë çdo fundjavë të ndërtuara për anetaret e klubit tonë. Tani është sezoni i dimrit dhe fokusi ynë janë fshatrat turistikë me borë ku ndër më kryesoret janë Voskopoja dhe Dardha në Korçë, si dhe herë pas here kemi dhe guida te ndryshme në Bogë (Kosovë), Mavrovë (Maqedoni), Kolashin (Mali i Zi). Kategoria tjetër janë guidat një ditore që zhvillohen brenda ditës, zakonisht të dielave. Zakonisht nga ora 9:00 - 17:00. Këto janë guida që zhvillohen në përgjithësi, në fshatrat e Tiranës që janë vërtet shumë të veçantë, si dhe në qytetet pranë saj. Mesatarisht jo më tepër se 3 orë rrugëe vajtje- ardhje. Pasi shkojmë në fshatin që kemi përzgjedhur, nisim marshimin, që varion nga 10 km deri në 25 km. Guidat 1 ditore janë shumë të ndryshme nga njëra- tjetra, disa kanë terren më të thjeshtë disa më të vështirë, disa janë më të gjata, disa janë më të shkurtra, por të gjitha janë të bukura. Gjithmonë pjesmarrësit mahniten me bukurinë e fshatrave të Tiranës dhe të qyteteve të tjera pranë saj. Disa nga guidat 1 ditore që kemi zhvilluar janë Shpella Pëllumbasit, Kalaja e Petrelës, Rera Hedhur, Shëngjin, Kanioni i Brarit, Kalaja e Prezës dhe Liqeni Shark, Shëngjergj - Mali me Gropa, fshati Gurrë, apo ngjitje në malin e Dajtit ku u bë edhe një ngjitje me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë.

**Klubi është vetëm për një grupmoshë e caktuar?**

Kjo është ndër pyetjet më të vështira, nuk e di pse njerzit mendojnë që ky klub është vetëm me një grupmoshë të caktuar, por është krejt e kundërta. Ka nga të gjitha moshat. Deri tani ne kemi pare nga 16 deri 82 vjeç (ky i fundit është vërtet rekord, dhe u dha një shembull të mirë të gjithë atyre të rinjve që e paragjykuan kur morën vesh moshën e tij). Ne kemi vetëm një kusht për moshën që është: Nuk ka rëndësi sa vjeç je, rëndësi ka që të ndihesh i ri, të jesh enregjik, i qeshur dhe të kesh dëshirë të njohësh me mirë bukuritë e vendit tënd.

> **Nuk e di pse njerzit mendojnë që ky klub është vetëm me një grupmoshë të caktuar, por është krejt e kundërta. Ka nga të gjitha moshat**

**Sa sportivitet kanë shqiptarët nëpër udhëtime?**

Duhet thënë që pas viteve '90 ka pasur një rënie të konsiderueshme të aktiviteteve sportive në Shqipëri, sidomos tek moshat e reja, kjo për shumë e shumëe arsye, por ajo që mund t'i vinte fre është mungesa e përgjegjësisë shoqërore për të patur një shoqëri të shëndoshë, plot sport dhe energji. Është e patolerueshme që të shohësh rininë shqiptare që ditën e diel ose të gjithë fiundjavën e kalon kafeneve dhe klubeve. Ajo që është më e patolerueshme është fakti që duke qenë pasiv në sport, ata janë pasivë dhe në jetë. Gjithsesi mendoj që po ndryshojnë, ne shohim që dita- ditës kemi plot të rinj, që ndoshta herën e parë vijnë për kuriozitet, për të provuar diçka ndryshe, sepse kanë dëgjuar që kalohet mirë, dhe më pas rikthehen me dëshirën për të parë një fshat tjetër, për të bërë më shumë ecje në natyrë, për tu ngjitur më lart. Kjo tregon që po ndryshon. Ne jemi munduar që këtë gjë të bëjmë TREND, sigurisht që po ia arrijmë falë anëtarëve tanë, janë ata ambasadorët tanë, janë ata që çdo herë vijnë me të rinj në grup, që u tregojnë për eksperiencat e kaluara dhe që i inkurajojnë të bëhen pjesë, janë ata që herë pas here na mësojnë sesi duhet t'i organizojmë guidat e ardhshme.

### Dardha dhe Voskopoja më të lakmuarat

Ndonëse ofertat për turizmin dimëror janë më shumta për udhëtime jashtë vendit, dy pika turistike shqiptare janë ndër më të preferuarat për këtë vit. Dardha dhe Voskopoja janë thuajse të parezistueshme për të gjithë ata që dëshirojnë të bëjnë një udhëtim drejt borës, ushqimit të zonës dhe rrëshqitjeve me ski dhe vizitës në disa objekte të trashëgimisë kulturore. Përvec udhëtimeve individuale apo në grup janë edhe paketa të ndryshme nga klube apo agjenci që ofrojnë udhëtimet dy -tre ditore në këto dy pika shumë të njohura dhe të lakmuara turistike, kundrejt një pagese që në varësi të opsioneve fillon ng 4900 deri në 9900 lekë të reja.

## Konkursi

### Të rilindësh "Made in Albania"

Në një treg artizan të përmbytur nga produktet kineze dhe turke, "Made in Albania" ka humbur thuajse tërësisht. I mbetur në pakicë ku më shumë e ku më pak prodhimi shqiptar, ai cilësori që u mbajt gjallë në Ndërmarrjen Artistike "Migjeni" mbahet vetëm nga disa artizanë të vjetër, ndërsa brezi i ri po humbet gjithnjë e më shumë lidhjet me traditën. Por objektet artizanale janë një përbërës shumë i rëndësishëm i turizmit dhe i ekonomisë së vogël të një qyteze apo qyteti, fshati apo një pike turistike. Por një dritë jeshile sapo është ndezur dhe është pikërisht në Korçë, zonën më të preferuar në këtë stinë dimri . Bashkia Korçë së bashku me Organizatën për Manaxhimin e Destinacionit, Agjencinë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve si dhe me mbështetjen e Programit të GIZ "Zhvillimi Ekonomik dhe Nxitja e Punësimit" në Shqipëri kanë filluar organizimin e Konkursit Kombëtar të Suvenireve për Korçën. Aplikimet për pjesmarrjen zgjasin deri në datën 31 janar dhe organizatorët ftojnë të gjithë studentët dhe profesionistët në çdo fushë, që lidhet me industritë kreative dhe artizanë nga të gjitha rrethet. Pas mbylljes së aplikimit konkursi do të kalojë në disa faza ku synohet njohja e artistëve me Korcën dhe traditën artizane të qytetit me qëllim krijimin e modeleve sa më të mira. Qëllimi i Konkursit të 1-rë Kombëtar të Suvenirëve për Korçën është të rrisë tërheqjen e bizneseve dhe tregtueshmërinë e suvenirëve të frymëzuar nga Korça, si një model i lidhjes së kompozimit, tendencat tregtare bashkëkohore me traditën dhe trashëgiminë natyrore, historike, kulturore të rajonit të Korçës. Mendohet që konkursi të bëjë të mundur që suvenirët e frymëzuar nga rajoni i Korçës të bëhen më tërheqës për vizitorët si dhe të kontribuojnë në rritjen e kënaqësisë së vizitorëve me qëllimi zhvillimin e turizmit shqiptar.

## Dëshironi të shihni një film

**PREMIERA** *Përshtatja kinematografike e muzikalit më të famshëm, të shfaqur për herë të parë në vitin 1980, bazuar në romanin e Viktor Hugo*

### "Les Miserables", Muzikali më i mirë në Golden Globes. 17 nominime në Oskar dhe Bafta

# Shkëlqimi i "Të mjerëve" prek Tiranën

### Interpretojnë Hugh Jackman, Russell Crowe, Anne Hathaway, Amanda Seyfried

Ndërsa është në pritje të verdiktit nga Bafta dhe Oskar për 17 nominimet në këto dy gara të rëndësishme kinematografike, "Les Miserables" fillon projeksionet shqiptare në kinema Millennium, prej datës 25 janar. Me kritika pozitive, arkëtime të bujshme dhe tre statuja Golden Globes, dy nga të cilat për aktorin më të mirë Hugh Jackman dhe për aktoren më të mirë joprotagoniste, Anne Hathaway muzikali "Les Miserables" po përjeton ditët e tij të famës ndërsa gjeografia e projeksioneve është shtrirë thuajse në mbarë botën. Filmi, i vlerësuar nga Golden Globe si prodhimi më i mirë në gjininë e komedisë dhe muzikalit, është një produksion britanik i realizuar nga regjisori i Tom Hooper, i njohur për filmin "Fjalimi i mbretit". Ai është shkruar nga William Nicholson, Boublil, Schönberg dhe Herbert Kretzmer, ndërsa në rolet kryesore janë aktorët e njohur Hugh Jackman, Russell Crowe, Anne Hathaway, apo Amanda Seyfried. Në krah të tyre interpretojnë edhe aktorët Sasha Baron Cohen edhe Helena Bonham Carter.

**SKEDA E FILMIT**

**Regjia:** Tom Hooper

**Skenari:** William Nicholson

**Muzika:** Claude-Michel Schönberg

**Aktorë:** Hugh Jackman, Russell Crowe, Anne Hathaway, Amanda Seyfried, Eddie Redmayne, Samantha Barks

**Gjinia:** Dramë, Muzikal

**Sinopsi:** Ish I burgosuri Zhan Valzhan përndiqet prej vitesh nga polici Zhaver. Kur Valzhan bie dakort që të kujdeset për vajzën e Fantinës, Kozeta, jeta e tyre ndryshon përgjithmonë.



"Les Misérables" është përshtatja kinematografike e muzikalit të shkruar në vitin 1980 nga Claude-Michel Schönberg (muzika) dhe Alain Boublil (teksti). Ky ishte muzikali më i gjatë në historinë e Ëest End që zuri vend në ekranin e madh që u bazua në romanin e fashmëm të Viktor Hugo. Në Francën e gjysmës së dytë të shekullit 18, protagonisti i historisë Jean Valjean, sapo ka dalë nga burgu. Me një emër të rremë, bëhet një sipërmarrës fatlum dhe kryetar i bashkisë së një qyteze franceze. I përndjekur nga inspektori Javert, është i detyruar që të lëvizë vazhdimisht, duke marrë me vete jetimen Kozeta, të cilën e rrit si bijën e tij.

Deri më 21 janar "Les Misérables" arkëtoi mbi 131 milionë dollarë në Amerikën e Veriut dhe mbi 150 milionë dollarë në mbarë botën. Gjatë fundjavës së parë të projeksioneve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës filmi theu rekordin e javës së që mbahej nga një muzikal dhe që ishte vendosur nga "High School Musical 3: Senior Year". "Les Misérables" ka marrë edhe shumë kritika pozitive. "Daily Telegraph" e ka vlerësuar si një prodhim ku efektet speciale japin emocione të forta. Media është treguar pozitive ndaj aktrimit të Anne Hathaway sidomos në performancën e saj me baladën "I Dreamed a Dream" të krahasuar me Jennifer Hudson në "And I Am Telling You I'm Not Going" tek "Dreamgirls". Dhe në fakt Anne ia ka dalë të fitojë Golden Globes si aktorja më e mirë joprotagoniste sikundër është nominuar në të njëjtën kategori edhe në cmimet Bafta dhe Oskar.

## Duartrokitje shqiptare për "Django ..."

Me 2 çmime Golden Globe për skenarin më të mirë nga Quentin Tarantino dhe aktorin më të joprotagonist nga Christoph Ëaltz, si edhe me 5 nominime Oskar, "Django Unchained" e kishte thuajse të rezervuar pritjen e mirë nga publiku shqiptar. Por me sa duket magjia Tarantino dhe e gjithë grupit të filmit, ia ka dalë të shkëpusë jo vetëm pëlqime e diskutime por edhe duartrokitje të gjata. Gjatë disa projeksioneve në kinema Millennium që nga i pari më 18 janar e deri më sot janë shënuar disa herë reagime të tilla, kur njerëzit kanë shprehur admirimin ndaj filmit me duartrokitje, edhe pse nuk bëhej fjalë për një premierë me apo pa protagonistë. Dhe kjo duket më se normale për një produksion me firmën Tarantino dhe një kast të sofistikuar aktorësh si Christoph Ëaltz ,Jamie Foxx, Leonardo Di Caprio,Samuel L. Jackson dhe Kerry Ëashington. Ngjarjet e filmit vendosen në jug të Shteteve të Bashkuara të Amerikës para luftës civile. Django (interpretuar nga Jamie Foxx) është një skllav historia e tmerrshme të cilit me ish pronarët e tij e con ballë për ballë me Dr. King Schultz (interpretuar nga Christoph Ëaltz) i cili është në kërkim të kriminelëve vëllezër, Brittle. Vetëm Django mund ta drejtojë për tek ata, ndaj Schultz ble Django me premtimin se pas kapjes së vëllezërve Brittles, gjallë apo vdekur do t'i japë lirinë. Suksesi i këtij operacioni e bind Schultz që të lërë të lirë Django. Por edhe pas kësaj ata të dy nuk ndahen nga njëri tjetri. Ndërsa Schultz drejtohet në jug për të kapur kriminelët e shumëkërkuar falë ndihmës së Django, ky i fundit përqendrohet në lirimin e gruas së tij, sklaves Broomhilda (intepretuar nga Kerry Ëashington), të cilën e humbi vite më parë. Kërkimi i Django e Schultz i drejton të dy për tek Calvin Candie (interpretuar nga Leonardo DiCaprio), pronar i Candyland, një plantacion ku skllevërit stërviten nga Ace Ëoody (intepretuar nga Kurt Russell) për të mundur me njëri-tjetrin. Duke eksploruar plantacionin, Django e Schultz ngjallin dyshime tek Stephen (interpretuar nga Samuel L. Jackson), skllavi besnik i Candie-t. Lëvizjet e tyre kontrollohen nga të gjithë dhe fillojnë përpjekjet për asgjësimin e tyre.




**SKEDA E FILMIT**

**Titulli:** "Django Unchained"

**Regjia:** Quentin Tarantino

**Skenari:** Quentin Tarantino

**Aktorë:** Jamie Foxx, Leonardo DiCaprio, Christoph Ëaltz, Samuel L. Jackson, Gerald McRaney, Dennis Christopher, Laura Cayouette,

**Gjinia:** Aksion aventure

Filmi i Tarantinos është vlerësuar maksimalisht si nga kritika ashtu edhe nga publiku amerikan. "filmat e Tarantino"- shkruan Roger Ebert gjatë recensionit të tij për "Django Unchained" -"janë një sfidë e drejtpërdrejtë për shumë tabu të shoqërisë sonë ..." . Los Angelos time shkruan se "Në "Django", Tarantino është një njeri i cliruar nga prangat, duke krijuar filmin e tij më të artikuluar, më intrigues, provokues, më të tmerrshëm,më të ashpër dhe të çiltër e zbavitës".

Ndërkohë që projeksionet europiane kanë ngritur siparin e tyre që në datën 16 janar fundjava finalizon shtrirjen e plotë të filmit në të gjitha sallat e kontinentit të vjetër përfshirë edhe Shqipërinë. Filmi vjen në një kohë kur mbahen garat më të rëndësishme kinematografike të vitit. Deri tani filmi ka marrë 20 nominime dhe 13 çmime, mes të cilëve AFi Aëard që e vlerësoi si filmin më të mirë të vitit. Cmimet e fituara i kanë takuar kryesisht Quentin Tarantinos dhe aktorit Christoph Ëaltz, por disa prej nominimeve janë shndërruar në trofe edhe për aktorin Leonardo Di Caprio. Dy "betejat" e fundit për "Django Unchained" janë Bafta dhe Oskar, që zhvillohen përkatësisht në 10 dhe 24 shkurt. "Django unchained" ka pesë nominime në secilën prej tyre.

**PROGRAMET E KINEMASE**

**NE FUNDJAVE**

**KINEMA MILLENIUM**

**Filmat në sallë**

**"Les Miserables"**
(Në të gjitha oraret)

**Django unchained**
(Në orën 21.00)

**Gambit**
(Në orën 10.30)

**Orari dhe Çmimet**

**Filmi 2D**
ora 10:30 – 300 lekë
ora 13:00 – 300 lekë
ora 15:30 – 500 lekë
ora 18:00 – 500 lekë
ora 20:30 – 500 lekë
ora 23:00 – 500 lekë

**Filmi 3D**
ora 10:30 – 500 lekë
ora 13:00 – 500 lekë
ora 15:30 – 700 lekë
ora 18:00 – 700 lekë
ora 20:30 – 700 lekë
ora 23:00 – 700 lekë

**NE FUNDJAVE**

**KINEMA IMPERIAL**

**Filmat në salla**

**"Les Miserables"**
(Në të gjitha oraret)

**Django unchained**
(Ora 20:00)

**Orari dhe Çmimet**

ora 13:00 – 500 lekë
**Qendra Kristal**
ora 18:00 - 500 lekë
**Qendra Kristal**"
ora 12:30 - 500 lekë
**AGIMI**
ora 17:30 - 500 lekë
**AGIMI**
ora 20:00 - 500 lekë
**AGIMI**
ora 22:00 - 500 lekë

# Dëshiron të qëndrosh në shtëpi

**VLERAT** *e Panxharit të kuq dhe kush është Topinambur ose fruit-zarzavat I njohur ndryshe si argjinarja e Jeruzalemit*

Luga e argjendtë

Receta nga Dhurata Thanasi

## Antipastë me Panxhar të kuq dhe Topinambur



*vijon nga faqja 13*

...vjeçare, e cila është në gjendje të rritet në lartësi 1-5 metra. Pjesa mbitokësore e saj është shumë e ngjashme me luledielli, ndërsa pjesa nëntokësore-ushqimore është si një patate, por me shije ndryshe. Si bimë ka ardhur nga Amerika e Veriut, në versione të disa llojeve të egra. Kontakti i parë masiv me këtë kulturë ishte gjatë një thatësirë të madhe në vitin 1612. Njerëzit ishin të uritur dhe rrënjët tuberoze luajtën një rol të rëndësishëm në shpëtimin e jetëve të shumë fiseve. Në vitin 1605, marinarët francezë sollën këtë bimë në Evropë, sidomos në Francë. Emrin e saj-Topinambur u dha nga fisi indian Tupinamb. Falë efekteve të saja mjekësore dhe të shijshme, ajo u përhap shpejt në të gjithë Evropën. Topinambur është i njohur për mbi 3000 vjet. Ajo është një bimë që lejon të mbijetojë në kushte ekstreme të ndryshme, nga shkretëtira Sahariane deri në Alaska. Përsa i përket korrave, kjo është shumë më e madhe në krahasim me bimë të tjera. Topinambur eshte një frut/ zarzavat që ka vlera të jashtëzakonshme. Përveç inulit, topinambur përmban komponimet e tjera biologjikisht aktive si: fibër, hekur, silic, minerale si zink, manjez, kalium fosfor, kalcium dhe vitamina B, C, komponimet pektin, acide organike dhe aminoacidet. Topinambur rregullon presionin e gjakut dhe procesin e tretjes. Ajo mbron mëlçinë dhe veshkat. Si dhe për të rritur imunitetin e organizmit në rast të infeksioneve, vepron kundër stresit, ofron energji për organizmin dhe rrit aftësinë e përqendrimit. Topinambur rekomandohet edhe për parandalimin e osteoporozës. Në Shqipëri ka filluar të hyjë edhe pse nuk njihet ne disa supermarkete kryesore. Për t'i ndërthurur bukur dhe me shije unë kam përgatitur një antipastë (recetë origjinale e Lugës së Argjendtë) ku si

### Detaj

**Për 4 vetë**
**Përbërësit:**
2 kokrra Panxhar të kuq
1 topinambur
1 limon
3 vezë të zjera
Vaj ulliri
Senape 3 lugë kafeje
Kripe,
Piper i zi
Uthull balsamike



Panxhari i kuq ashtu dhe Topinambur janë së bashku.

**ANTIPASTË ME PANXHAR TË KUQ DHE TOPINAMBUR**

**Përgatitja**:

Për përgatitjen e kesaj antipaste shumë të shijshme fillojmë me zjerjen e kokrrave të panxharit të kuq. Pasi është zier i presim në copa shume te vogla dhe i marinojmë me lëngun e nje limoni, piper të zi dhe vaj ulliri dhe kripë. Mëpas marrim Topinabur dhe e presin dhe ate ne cipa të të njëjtës madhesie si rrrepat, hedhim pak lëng limoni, kriposim, vajosim dhe e lemë menjeane. Marrim vezet e zjera dhe ndajmë të verdhen nga pjesa e bardhë. Pjesën e bardhë e presim ne coipa te vogla kubike dhe e bashkojmë me copat e Topinambur. Ndërsa të verdhën e vezës e hedhim në një mikser i shtojme pak vaj ulliri, lugët me senape dhe e bejme nje krem. Mëpas villojme me shtrimin e antipastës, shtresa e parë panxharin e kuq, mëpas topinambur me të bardhën e vezës, dhe shtresa e tretë kremi i të verdhës së vezës. Unë e vendos ne nje formë të hapur dhe e prezantoj si ne foton përkarshi. E zbukuroj me vaj ulliri dhe salce balsamike. Ka një shije të mrekullueshme!

### Profil

## Vlerat e panxharit



Për shije, lëngun e panxharit mund ta përziejmë me lëng molle, karrote, portokalli, limoni. Fillimisht nuk duhet ta ekzagjeroni në mase, por duhet ta filloni të provoni nga pak sa trupi juaj të mësohet me lëngun e panxharit.
Panxhari i kuq është bar natyror për të ruajtur organizmin sa më të ri, tërheq lëkurën, neutralizon acidet e tepërta në stomak, aktivizon krijimin e rruazave të kuqe të gjakut dhe rrit ose përmirëson humorin mjaft të domosdoshëm për një ditë të bukur.

**Receta 2**

## Tortë e shpejtë me mollë

**PËRGATITJA:**

Për përgatitjen e petës marr miellin një majë luge kafeje kripë, i marr dhe i përziej dhe bëj brumë. Gjalpi duhet te ne temperature ambjenti. E shtrij si pete dhe e vendos ne nje tavë dhe pergatis nga ana tjeter: 4 molle në feta te holla, lëngun e 1 limoni, 2 lugë gjelle sheqer të tipit canna (kaf), pak kanellë dhe pak arre moskati. Marr mollët dhe I pres në copa të holla dhe i hedh në nje tigan me bazë të gjerë derisa fillojnë të nxjerrin paksa lëngun, shtoj sheqerin dhe sapo fillojnë të karamelizohen shtohet lëngu i limonit. Në momentin kur është avulluar shtohet arrë moskati dhe kanellë, unë preferoj ti grij në moment të freskëta. Pastaj i hedh në petën e hapur dhe kthej anët e saj.E zbukuroj me një mollë të freskët përsipër, të prerë në feta të holla dhe pak sheqer të trashe dhe bajame. E fus në furrë me ventilim për gati 40-45 minuta dhe temperaturë në 180 gr celcius. E servir të ngrohtë dhe e shoqëroj me çaj jasemini.

### Përbërësit

Një petë Brisee (gjendet tek Conad ose në çdo supermarket)
Për pastën Brize:
150 gr miell, 30 gr gjalpë, 30 gr ujë
**Për mbushjen**
4 kokrra mollë të tipit renet
2 lugë gjellë sheqer kaf
pak kanellë, pak arrë moskati
bajame të pjekura, sheqer pluhur për zbukurim

**DETAJ**

Një nga gjërat që une bëj është përgatitja e pastës brisee me miell integral ose të tipit Kamut, E bej pastën brize me shumicë dhe e mbaj në ngrirje të ndarë në porcione dhe e përdor kur më duhet.






### PROGRAMACIONET DHE FILMAT NE TV

**SOT**

**TOP-CHANNEL**
**20:06** "Fiks Fare"
**20:45** "The Voice of Albania 2"

**KLAN**
**20:10** Te lire per te luajtur serial premiere, ep.1/3
**21:00** Zone e Lire

**VIZION+**
**20:05** Lugina E Ujqerve - Serial Turk
**21:00** Me kap nese mundesh *Film*

**DIGITALB**
**19:00** "88 minuta" *Triller*
**21:00** "Centurioni" *Aksion*

**E SHTUNË**

**TOP-CHANNEL**
**20:15** "Pop-Channel"
**20:35** " 1001 Pse 2"

**KLAN**
**20:10** Operacioni odise *serial premiere, ep.1/1*
**21:00** 100 VJet muzike nata 16 LIVE

**VIZION+**
**20:00** Mos e beso po deshe (R) - Emision
**21:00** AL PAZAR - The Best Of Nr.2

**DIGITALB**
**19:30** "Kremtimi i 4 korrikut" *Komedi*
**21:00** "Sozia e djallit" *Hits*

**E DIEL**

**TOP-CHANNEL**
**20:12** Exclusive
**20:45** "Rescue Dawn Xhungla e eger" *Film*

**KLAN**
**19:35** Anatomia E Greit serial premiere pj142
**20:55** X Factor Albania 2 *nata 7*

**VIZION+**
**19:45** Fresk Fare
**20:45** Harri poter dhe kupa e zjarrte

**DIGITALB**
**21:00** "Këmbimi" *Autor*
**21:10** "Qelia" *Triller*

## Debatet

**ÇFARË FSHEHIN** *dialogjet e veprës së Dokles, që e kanë zemëruar kishën ortodokse? Një lexim i dramës "Shën mëria e Beratit", zbulon pakënaqësitë dhe revoltën...*

# DRAMA PROVOKUESE E DOKLES

## Ja çfarë e ka zemëruar Metropolinë

### Pjesë nga dialogjet. Murgu Kozma: nuk është Shën Mëria, por ajo kuçka e vogël

TIRANE

Admirina Peçi

Shën Mëria e Beratit", drama e Namik Dokles e ka zemëruar keqazi Kishën Ortodokse. Pasi u ndalua të shfaqej në skenë e Teatrit të Korçës, autori i dramës Dokle e quajti talebanizëm ndalimin e dramës së tij. Por çfarë ka ngacmuar kjo dramë? Çfarë herezish fshehin dialogjet e personazheve të Dokles? Një lexim i dramës, na zbulon ngacmimin e vërtetë. E shkruar në 2010, kjo dramë e Namik Dokles, vënë në skenë në teatrin Andon Zako Çajupi, na zbulon që në dialogjet e para se një mëkat i madh ka ndodhur, ndërsa nga duart e piktorit Amofr që nënkupton Onufrin, ka dalë një ikonë e qujtur Shën Kostandini, frymëzuar nga legjenda e Doruntinës dhe Kostandinit. Murgu Kozma i thotë murgut shqiptar Todri: "Kjo është ikona e djallit!" ...ma quan Shën Kostandin?! ...Është nxjerrë nga varrezat e ndonjë humbëtire të Arbrit tuaj.

E këtillë, me dialogje që provokojnë, kjo dramë e Dokles duket se do të debatohet gjatë. Edhe sot Metropolia doli me një reagim të ashpër duke e quajtur provokim dhe fyerje...

Por a janë frazat thumbuese të kësaj drame, shkaku i reagimit të Metropolisë së Korçës? Apo shkaku i vërtetë qëndron në këndvështrimi që e sheh vetë Dokle, si një vepër që i jep dritë kishës autoqefale që themeloi Noli...

Lexuesve të Shqiptarja.com, iu sjellim disa pasazhe të shkëputura prej saj, për të krijuar një ide më të qartë mbi këto debate e përplasje.



Foto nga drama e drama e Namik Dokles

### PJESË NGA DRAMA E NAMIK DOKLES

**Kozmai** - Jam murgu Kozma , i dërguari i Patrikanës.

**Todri** - Domethënë... të paska sjellë Patrikana, jo Zoti, murgu Kozma?

**Kozmai** - Punët e Patrikanës, janë punë të Zotit, murgu Todër. (Xhozepës):

**Kozmai**- Kjo është ikona e djallit!

- Çfarë ka bërë, që të mendohet e tillë?

**Kozmai**- Nuk e shikon?! Nuk e shikon emrin e këtij që ma quan Shën Kostandin?!

(Ja merr ikonën nga dora). Ja... Shën Kostandini i Arbrit(!!!)

**Todri** - Nuk qenka nga Bibla!?

**Kozmai**- Çfarë Bible?! Është nxjerrë nga varrezat e ndonjë humbëtire të Arbrit tuaj

- Eheeee...

**Kozmai** - (Humb qetësinë). Nuk e kupton apo bën me sikur... Qorri më i keq është ai që nuk dëshiron të shikojë, murg Todri. Unë, që ta marrësh vesh ti, nuk vij nga stanet e Tomorit, por nga Patrikana e Stambollit! Dhe e di që ty të mbajnë për më të diturin e këtyre anëve. Mos më thuaj që nuk e ditke legjendën tuaj të Kostandinit dhe të Doruntinës. Dhe ja ky (përplas dorën mbi ikonë), na e sjell legjendën tuaj në ikonë! Mëkat më të madh nuk ka parë ndonjëherë Patrikana jonë e shenjtë. Dhe çfarë mynxyre?! Këtë Kostandinin tuaj ma ka shkruar edhe Shenjtor!

**Todri** - Ndoshta për këtë ka gabuar, por ajo legjenda jonë është e bukur. Besa e dhënë është shenjë e perëndisë. Ne i japim besë edhe Zotit, edhe robit...

**Kozmai** - Ashtu?! Harroni ju, që në gjithë këtë rruzull, është vetëm një, vetëm Jezusi që u ringjall dhe nuk mund të ketë një të dytë, që të ngrihet nga varri?! Dashkeni të na bëni Krisht të dytë ju!? Krishtin e Arbrit? Krishtin e besës?! Duhet të luteni për këtë mëkat, murgu Todër!

* * *

**Kozmai** - E adhuron?!

**Todri** - Është ikonografi më i mirë në Arbër.

**Kozmai** - Por që e dhjeu me Kostandinin!

**Todri** - O Zot, fale për këtë fjalë që mban erë të keqe në shtëpinë tënde!

**Kozmai**- Lëre atë lutje, lëre! Nuk më the çfarë kuptimi ka emri i tij. (Tregon me gisht ikonën).

**Todri** - Është emër i vjetër i gjuhës tone, ilirishtes...

**Kozmai** - Gjuha e barbarëve... E mora vesh

* * *

**... Amofri**- Si të duket, të pëlqen?

**Maria**- Thanë që do të vijë Kryepeshkopi për ta parë.

**Amofri** - Le të vijë edhe kryedreqi po të dojë. Ata kanë punën e tyre, unë timen. Puna e tyre do të vdesë shpejt, kurse unë dua të lë në këtë kishë të lashtë një shenjë përjetësie.

***

**Amofri** - Murgu i shkretë! Ka njëmijë vjet i mbyllur këtu e nuk e di ç'ndodh pas qoshes ku ai lutet e i falet Jezusit... (Provon të hedhë ndonjë penelat në ikona po nuk i shkon. Pastaj ngul sytë tek njëra prej tyre, e prek me mollëzat e gishtave, e pastron me delikatesë dhe e vëren me imtësi). Pa shiko! Kjo duhet të jetë e mjeshtrit të madh të Ilirisë! Murgu plak nuk qenka dhe aq budalla! (Vjen me nxitim një vajzë 17-18 vjeçe, paksa imcake por shumë e bukur. Ajo ka një shandan me qirinj të ndezur dhe piktori pa i hedhur fare sytë asaj, rrëmben shandanin dhe i afrohet ikonës. E ndriçon nga të gjitha pozicionet). Ajo është! Ajo! (I jep shandanin vajzës). Më bëj dritë këtej më lart... (Vazhdon të vëzhgojë e të lëmojë me mollëzat e gishtave ikonën). Më lart të thashë... Pak pjerrtas... Di të mbash shandan ti, moj çupë?! Kush të solli ty?! (Vajzës i bie shandani nga dora, piktori i tronditur e ngre, rregullon qirinjtë dhe ia afron vajzës te fytyra. Ajo qan në heshtje... Piktori i fshin lotët butësisht). Kush të solli ty, thashë...Vetë perëndia të paska sjellë. Si e ke emrin?

**Maria**- Mari.

**Amofri**- Oh, paske emrin e Shenjtores. Dhe je po aq e bukur sa ajo. (Afron shandanin më pranë ikonës). Ke dëgjuar ndonjëherë për mjeshtrin e madh të Ilirisë?

**Maria** - Jo, nuk kam dëgjuar...

**Amofri** - (Me sytë te ikona). Pse nuk ke dëgjuar?!

**Maria**- Jam e re... Jam e re si murgeshë...

**Amofri**- Afrohu pak... E shikon syrin e Shën Mërisë? Ky është syri më i bukur që ka parë bota. Askush nuk e ka vizatuar më të bukur se sa mjeshtri ynë.

**Maria** - Pse, syri i Shenjtores nuk është i njëjtë kudo?

**Amofri**- (Qesh). Jo, vogëlushe. (Ajo skuqet nga kjo përkëdheli dhe ul kokën). Nuk është njëlloj. Çdo piktor fut shpirtin e tij në sytë e Shenjtores dhe shpirtrat e piktorëve ndryshojnë si ata të të gjithë njerëzve. A e shikon që këtu Shën Mëria ka vetëm njërin sy?

**Maria**- Po tjetrin ku e ka?

**Amofri** - E kanë verbuar, ia kanë shkulur me thikë ose acid. Ata që nuk e duan Arbrin tonë.

**Maria**- Oh, çfarë tmerresh tregoni ju!

**Amofri**- Unë vetëm i tregoj, të tjerët i bëjnë... (Ulet i menduar përbri ikonës). Fati i madh që ka shpëtuar të paktën njëri nga sytë... (E shikon Marinë). Po ti i ke të dy sytë të bukur.

* * *

**Kozmai** - Pse e fsheh, bija ime?

**Maria** - Nuk kemi leje ta shikojmë.

**Kozmai**- Kush jep leje, moj bijë? Patrikana e Stambollit apo çifutët e Beratit?

**Maria** - Nuk njoh asnjërin syresh, por piktori ka thënë mos ta shohë njeri...

**Xhozepa**- Po ju pse e zbuluat atëherë?

**Maria** - Bëmë mëkat, bëmë mëkat të madh.

**Xhozepa**- Kush e bëri?

**Maria** - Unë...

**Tereza**- Jo, unë e zbulova... Më tha...

**Xhozepa**- Mbylle ti, në mos po të dalin gjarpërinj nga goja jote.

**Maria**- Unë e bëra mëkatin.

**Xhozepa**- Na jep pak nga mëkati yt, Mari, të ta lehtësojmë barrën e madhe që të ka zënë nën vete. Je e re, nuk e mban dot vetëm mëkatin... Dëshiron borzilok apo hithër nga fytyrën tënde të butë? Borzilok Parajse apo hithër Ferri? (Afrohet për të zbuluar ikonën). Mari, na lër ta shikojmë Shën Mërinë....

**Maria**- (E tromaksur, e pafuqishme...). Murgu Todër! Murgu Todër... (Kozmai e kap për krahu, e shtyn tutje në duart e Xhozepës. Murgu Kozma heq napën dhe zbulon ikonën. Maria shkëputet nga duart e Xhozepës dhe vrapon në thellësi të kishës... duke thirrur akoma më fort). Murgu Todër, murgu Todër.

**Kozmai**- (Xhozepës dhe Terezës). Më sillni qirinjtë! (Ato ia afrojnë, ky ua merr nga duart dhe bën vetë dritë mbi ikonë. E vrojton me imtësi). E shikon se ç'bëhet këtu nëna murgeshë?! Kjo nuk është Shën Mëria, por ajo kuçka e vogël që i ka vjedhur edhe emrin Shenjtores. O Perëndi, çfarë mëkati i madh në këtë kishë të vogël! Edhe turpi më i madh do të skuqej po ta shikonte...

**Todri** -(Vjen me ngut, gjysmë i veshur me rrobë nate) Çfarë ka ndodhur? Kush u vra?

**Kozmai** - Nuk është vrasje, por më e përgjakur se njëmijë vrasje të bëra bashkë! Më zi se Hadi dhe më tepër përvëlim nga sera që digjet në Ferr. (Todri që po afrohet). E shikon?

**Todri** - (Merr një qiri në dorë, e shikon i etur ikonën, e prek butë-butë me dorë, sikur e përkëdhel). Shën Mëria... Shën Mëria e gjallë! Ajo po flet me ne... e shikoni? Po flet... po buzëqesh. Është Shën Mëria jonë! Për herë të parë me Jezusin në krahë të djathtë.

## Reagimi i Mitropolisë

# Vazhdojmë të protestojmë se drama denigron klerikët

Pas takimit me drejtoreshën, Zamira Kita, Mitropolia e Korçës ka reaguar zyrtarisht nëpërmjet një deklarate për mediat në lidhje me vënien në skenë të dramës së Namik Dokles "Shën Maria e Beratit". "Për komunitetin Ortodoks kjo është një dramë denigruese dhe fyese, sepse denigrimi i klerikëve të nderuar ortodoksë është denigrim për të gjithë komunitetin", thuhet në deklaratën zyrtare të Mitropolisë. Mitropolia e Korçës vijon të mbajë ende qëndrimin e një dite më parë ndaj shfaqjes duke deklaruar se këtë e bën se "ka kohë që besimi ortodoks po goditet gjithandej me mënyra të ndryshme. Veprime të tilla nxisin reagimin e çdo besimtari,si dhe cenojnë ruajtjen e harmonisë dhe bashkëjetesës fetare,si vlerë që karakterizon shoqërinë tonë", thuhen ë deklaratën zyrtare te Mitropolisë. Deklarata është cituar nga Ikonom Stavrofor At Ilia Kotnani që tha se: "Me anë të kësaj deklarate, protestojmë ndaj këtyre fenomeneve dhe i drejtohemi opinionit qytetar të Korçës, por edhe më gjerë që të kuptojnë se veprime të tilla që cenojnë komunitetet e ndryshme fetare ,të qëllimshme ose jo,nuk i shërbejnë interesave të qytetit, të bashkëjetesës fetare dhe përparimit të shoqërisë Shqiptare"..., etj.



## Legalizimet

**ALUIZNI:** *Lista e re me legalizimet e banorëve, pronarë të ndërtimeve informale në qarqet e vendit*

# VKM: Tapitë e kompensimet e reja

### Brenda 48 orësh nga pagesa, pajisja me lejen; Agjencia e Legalizimeve ka vendosur si objektiv që procesi për objektet pa leje të përmbyllet brenda vitit 2013

**TIRANE**

ALUIZNI publikon sot listën e qytetarëve në proces legalizimi, të cilëve u është miratuar kalimi i pronësisë, si dhe listën e pronarëve të ligjshëm të trojeve të zëna në mënyrë të paligjshme, të cilëve u është miratuar kompensimi financiar, hapa drejt produktit final të procesit, lejeve të legalizimit. ALUIZNI fton ndërtuesit informalë të kryejnë sa më parë detyrimet ligjore të mëpasme , të shfrytëzojnë kohën dhe mundësitë për të plotësuar detyrimet e tyre, me qëllim përmbylljen e procesit brenda afatit të shpallur, vitit 2013. ALUIZNI është duke përpunuar dhe dhënë mesatarisht 2.250 leje legalizimi në javë, pra 10.000 leje legalizimi në muaj. Me këtë ritëm të fituar, të cilin shpresohet të shkojë drejt intensifikimit, çdo ndërtues informal duhet të jetë i sigurt se shumë shpejt do të jetë radha e tij për të parë emrin në gazetë dhe për të marrë lajmërimin e legalizimit të pronës së tij. Do të jetë kjo mënyra e vetme dhe më e drejta dhe transparentja e komunikimit midis nesh, duke premtuar se do të jemi të hapur, thekson në mesazhin e tij me këtë rast drejtori i përgjithshëm i ALUIZNI-t Ardian Kollozi, për të pritur e mirëkuptuar çdo shqetësim apo vërejtje të çdo personi të interesuar. Sipas ALUIZNI-t, pasi të kryhet pagesa e detyrueshme për procesin e legalizimeve, ky institucion do të pajisë me lejen përkatëse qytetarin e interesuar brenda një periudhe prej vetëm 48 orësh. Agjencia e Legalizimeve ka vendosur si objektiv që procesi i legalizimit të përmbyllet brenda vitit 2013. Ajo ka kërkuar që ndërtuesit informalë duhet t'u largohet sekserëve.

## Lista emërore sipas drejtorive rajonale për kalimin e se drejtës së pronësisë nga shteti te poseduesi i ndërtimit informal me vendim të Këshillit të Ministrave

**TIRANA 1**

| Emër | Atësia | Mbiemri |
|---|---|---|
| Roland | Safet | Çaushaj |
| Rei | Safet | Çaushaj |
| Jovanka | Dançe | Sharkaj |
| Petraq | Sokrat | Cari |
| Riza | Refat | Cuka |
| Skender | Ismail | Seferi |
| Albana | Islam | Tufa |
| Ilir | Avni | Xhomaqi |
| Xhemal | Hysen | Broca |
| Amalia | Kiço | Tola |
| Florian | Muhamet | Xhuti |
| Besim | Hajdar | Saka |
| Usli | Gafur | Kurtaga |
| Musa | Bajram | Hoxha |
| Mahmut | Shemsi | Zuna |
| Beqir | Dalip | Guri |
| Bukurie | Bexhet | Deda |
| Muhamet | Seran | Bici |
| Frederik | Muhamet | Bici |
| Arjanit | Muhamet | Bici |
| Hekuran | Hamit | Çupi |
| Halit | Ali | Klenja |
| Albana | Sokol | Musaj |
| Ymer | Ramazan | Koliqi |
| Perparim | Mestan | Hasani |
| Novrus | Tefik | Vrioni |
| Ali | Sinan | Iljazi |
| Erion | Ali | Iljazi |
| Emri | Haxhi | Vata |
| Spiro | Selman | Mema |
| Myseret | Hair | Bregu |
| Mustafa | Rakip | Kurti |
| Agim | Riza | Motina |
| Dritan | Muhamet | Dervishi |
| Vesel | Sulejman | Dalipi |
| Ylli | Sali | Memajdini |
| Afrim | Hekuran | Agalliu |
| Hekuran | Jaho | Agalliu |
| Andrea | Hekuran | Zhulati |
| Myzafer | Haxhi | Avdia |
| Hasan | Ali | Gjetani |
| Ilirjan | Vehap | Skenderi |
| Pandeli | Kosta | Pano |
| Naser | Faik | Begu |

**TIRANA 2**

| | | |
|---|---|---|
| Gezim | Avdyl | Vatoc |
| Shkelzen | Avdyl | Vatoc |
| Perparim | Osman | Bako |
| Nezir | Elmaz | Sula |
| Abdyl | Rustem | Bardhoshi |
| Shpetim | Halil | Farrici |
| Mus | Ibrahim | Imeri |
| Gani | Arif | Hasanpapaj |
| Islam | Shaban | Sadikaj |
| Gjovalin | Pjeter | Perpalaj |
| Rifan | Dajlan | Yzo |
| Muhamet | Sefer | Malo |
| Bernard | Gjon | Ndokaj |
| Xhevdet | Galip | Hoxha |
| Idriz | Shaban | Shiqerukaj |

**TIRANA 3**

| | | |
|---|---|---|
| Bashkim | Sulo | Dervishaj |
| Renata | Muhamet | Dervishaj |
| Jani | Laze | Duni |
| Jani | Laze | Duni |
| Alma | Xhezair | Teliti |
| Sotir | Trifon | Bushi |
| Rako | Koco | Xhavara |
| HAXHI | MEHMET | GURI |
| VLADIMIR | PANDELI | NOCKAJ |
| GARIP | FADIL | LAPA |
| ELI | PAVLLO | KUCUQI |
| DILAVER | ALI | BIBA |
| BASHKIM | BEQIR | MBROJA |
| BIMI | BEQIR | MBROJA |
| SAIMIR | ENGJELL | GAZHELI |
| FATBARDHA | TEKI | DAJA |
| FATBARDHA | TEKI | DAJA |
| LILJANA | NURI | TORO |
| FLAMUR | QEMAL | DACI |
| ZEF | NOC | SHALA |
| SOKRAT | NIKO | NANO |
| MEMO | DELI | CELA |
| EDUART | MUHAREM | KOLECI |
| FATOS | HAZIZ | HOXHA |
| FATOS | HAZIZ | HOXHA |
| JANI | THIMJO | VERLI |
| SUZANA | SHABAN | BACKA |
| BAKI | MUHARREM | AZIZAJ |
| EDMOND | SOKRAT | PLAKU |
| MAKSUT | BEKTASH | AGOLLI |
| ROBERT | AGO | TRUSHAJ |
| KRENAR | NEDIN | SKENDERI |
| RAMADAN | AXHEM | MERTIRAJ |
| ENVER | DALIP | IBRO |
| NEXHMEDIN | MUHARREN | GAZI |
